



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.133

6 tetor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 311 datë 16.9.2010	Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe lokale	7027
Ligj nr.10 312 datë 16.9.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe lokale (faza II)”	7055
Udhëzim i MPPT, MF dhe MITIK nr.31, datë 13.9.2010	Për përcaktimin e listës së shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar detar, ajror dhe të telekomunikacionit, të mallrave dhe pasagjerëve me TVSH zero	7060
Urdhër i MD nr.4846/18, datë 20.9.2010	Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e pajisjes e administrimit të vulave të përmbauesve gjyqësorë privatë	7061

LIGJ
Nr.10 311, datë 16.9.2010

PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI) PËR FINANÇIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe lokale.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6686, datë 27.9.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Numri FI </>
Numri SERAPIS 2007-0519

PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE
KONTRATË FINANÇIMI NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE
</>, </> 2010

Kjo kontratë lidhet ndërmjet: Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga z.Ridvan Bode, Ministër i Financave, në emër të Qeverisë si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi), si palë e parë, dhe Bankës Europiane të Investimeve, që ka selinë e saj në 100: boulevard Konrad Adenauer, Luxembourg, L-2950 Luxembourg, përfaqësuar nga (Banka) si palë e dytë.

Ndërsa:

1. Huamarrësi ka deklaruar që ai po ndërmerr një projekt (projekti), që është pjesë e një programi në vazhdim për rehabilitimin e rrugëve dytësore dhe lokale, duke përfshirë projektin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen në të gjithë Shqipërinë, që përshkruhet në përshkrimin teknik (përshkrimi teknik) të përcaktuar në grafikun A.1. Nxitës i projektit dhe përgjegjës për zbatimin e tij do të jetë Fondi Shqiptar i Zhvillimit (zbatuesi).

2. Kostoja e plotë e projektit vlerësohet nga Banka të jetë afërsisht 137 000 000 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë euro) dhe Huamarrësi ka deklaruar që ai synon ta financojë atë si më poshtë:

Burimi	Shuma (M euro)
Kredi nga Banka	50
Hua nga BERZH-i	50
Grande nga EWBJF-ja	4
Instrumenti i BE-së për paraaderimin (IPA) 2010 dhe 2011	33
TOTALI	137

3. Me qëllim që të përmbushet plani i financimit në paragrafin hyrës (2), Huamarrësi ka kërkuar nga Banka një kredi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë euro), ku kuptohet që pjesët përbërëse të projektit në lidhje me punët civile bashkëfinancohen nga Banka, BERZH-i dhe, sipas rastit, nga fonde të IPA-s.

4. Me vendimin nr.633/2009/EC, Parlamenti Europian dhe Këshilli i Bashkimit Europian kanë vendosur të japin një garanci për Bankën kundrejt humbjeve të shkaktuara prej saj në bazë të garancive të huave dhe huas së dhënë nga viti 2007 deri më 2011, në pajtim me rregullat dhe procedurat e saj, për projekte të kryera në vende të caktuara jashtë Bashkimit Europian të renditura në këtë vendim, ndërmjet të cilëve është Republika e Shqipërisë, më kusht që këto vende të kenë lidhur me Bankën një marrëveshje kuadër që të rregullojë aktivitetet e saj.

5. Marrëveshja kuadër që rregullon aktivitetet e Bankës në territorin e Shqipërisë, e nënshkruar më 5 shkurt 1998 nga Huamarrësi dhe Banka (marrëveshja kuadër) është e zbatueshme për këtë kontratë.

6. Banka është e mendimit që financimi i projektit përfshihet në objektin e funksioneve të saj, dhe duke pasur parasysh deklaratimet dhe faktet e cituara në këta paragrafë hyrës, ka vendosur të realizojë kërkesën e Huamarrësit duke i dhënë atij një kredi në shumën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë euro), në bazë të kësaj kontrate financimi (kontrata), me kusht që shuma e huas së Bankës të mos kalojë në asnjë rast 50% (pesëdhjetë për qind) të totalit të kostos së projektit, të përcaktuar në paragrafin hyrës (2).

7. Ministri i Financave është i autorizuar rregullisht për të nënshkruar kontratën me anë të dokumentacionit që gjendet në aneksin I të kësaj kontrate.

8. Statuti i Bankës parashikon që Banka siguron që fondet e saj përdoren në mënyrë sa më racionale që të jetë e mundur në interes të Bashkimit Europian; dhe, për pasojë, termat dhe kushtet e operacioneve të Bankës për huan duhet të jenë në pajtim me politikat përkatëse të Komunitetit Europian.

Në pajtim me rekomandimet e Task Force-s për veprim financiar, që është themeluar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Banka i kushton vëmendje të veçantë transaksioneve dhe marrëdhënieve të saj të punës [në ato raste kur ajo jep financim: a) për një projekt që ndodhet në një vend që nuk zbaton në masë të mjaftueshme ato rekomandime; ose b) për një huamarrës ose përfitues me qëndrim në atë vend].

9. Referencat në këtë kontratë te nenet, paragrafët hyrës, grafikët dhe anekset, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe, janë referenca përkatësisht te nenet, paragrafët hyrës, grafikët dhe anekset e kësaj kontrate.

10. Në këtë kontratë:

“Afati i pranimit” për një njoftim është:

(i) 16h00 ora e Luksemburgut në ditën e dorëzimit, nëse njoftimi dorëzohet më 14h00, ora e Luksemburgut në një ditë pune; ose

(ii) 11h00 ora e Luksemburgut në ditën pasuese në të cilën është ditë pune, nëse njoftimi jepet pas 14h00, ora e Luksemburgut në çdo ditë të tillë ose dorëzohet në një ditë që nuk është ditë pune.

“Autoriteti Shqiptar i Rrugëve” është agjencia e rrugëve e ngritur nga Republika e Shqipërisë.

“Ditë pune” është një ditë (e ndryshme nga një e shtunë apo e diel) në të cilën Banka dhe bankat tregtare janë të hapura për punë të përgjithshme në Luksemburg.

“Ngjarja e ndryshimit të ligjit” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 4.03A(3).

“Kontrata” ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin hyrës (6).

“Kredia” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 1.01.

“Njoftimi i livrimit” është një njoftim nga Banka drejtuar Huamarrësit në pajtim me dhe sipas nenit 1.02C.

“Kërkesë livrimi” është njoftimi kryesisht në formën e parashikuar në grafikun C.1.

“Mjedis” është sa më poshtë, në masën që ato prekin mirëqenien e njerëzve: a) fauna dhe flora; b) toka, uji, ajri, klima dhe panorama; dhe c) trashëgimia kulturore dhe mjedisi i ndërtuar, për zonën dhe përfshin shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, dhe efektet sociale të projektit.

“Ligji mjedisor” është ligji i BE-së dhe ligjet dhe rregulloret e brendshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe traktatet ndërkombëtare të zbatueshme, objektivi kryesor i të cilëve është ruajtja, mbrojtja ose përmirësimi i mjedisit.

“Instrumenti i borxhit të jashtëm” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 7.01.

“EURIBOR” ka kuptimin që i është dhënë në grafikun B.

“Data përfundimtare e disponibilitetit” është 31 dhjetor 2015.

“Norma fikse” është interesi vjetor i përcaktuar nga Banka në pajtim me parimet e zbatueshme herë pas here të përcaktuara nga organet rregullatore të Bankës për huat e dhëna me një normë fikse interesi, të përcaktuara në monedhën e transhit dhe që kanë termat e barasvlershëm për shlyerjen e kapitalit dhe pagesën e interesit.

“Transhi i normës fikse” është transhi i livruar me një bazë norme fikse.

“Norma e ndryshueshme” është një normë interesi e ndryshueshme me kurbë të caktuar, që do të thotë një normë interesi vjetor të barabartë me normën përkatëse ndërbankare ose plus ose minus *spread*-in e përcaktuar nga Banka për çdo periudhë pasuese reference së normës së ndryshueshme.

“Periudha e referencës së normës së ndryshueshme” është secila periudhë nga një datë e pagesës në datën tjetër përkatëse të pagesës, me kusht që periudha e parë e referencës së normës së ndryshueshme të fillojë në datën e disbursimit të transhit.

“Transhi me normë të ndryshueshme” është transhi i livruar me një bazë norme të ndryshueshme.

“Ngjarja e parapagesës së kompensueshme” është një ngjarje e parapagesës sipas nenit 4.03A e ndryshme nga paragrafët 4.03A(1) dhe 4.03A(2).

“Huaja” është shuma e përgjithshme e transheve të livruara herë pas here nga Banka në bazë të kësaj kontrate.

“Ngjarje e deformimit të tregut” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 1.06B.

“Ndryshim material negativ” është, në lidhje me Huamarrësin, çdo ngjarje ose ndryshim gjendjeje, krahasuar me gjendjen në datën e kësaj kontrate, që ndikon mbi Huamarrësin, që sipas mendimit të Bankës: 1. ndikon negativisht në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij financiare dhe të tjera në bazë të kësaj kontrate; 2. ndikon negativisht në gjendjen financiare të Huamarrësit; ose 3. ndikon negativisht në çdo garanci të dhënë nga Huamarrësi.

“Data e maturimit” është data e fundit ose e vetme e shlyerjes së një transhi të përcaktuar në pajtim me nenin 4.01A(b)(iii) ose nenin 4.01B.

“Transhi i njoftuar” është një transh në lidhje me të cilin Banka ka nxjerrë një njoftim livrimi.

“Data e pagesës” do të thotë: datat vjetore, gjashtëmujore ose tremujore në njoftimin e disbursimit deri në datën e maturimit, përveç kur, në rast se kjo datë nuk është një ditë përkatëse pune, kjo do të thotë:

(i) Për një transh të normës fikse, dita pasuese përkatëse e punës, pa iu përshtatur interesit të kërkueshëm në bazë të nenit 3.01, përveç atyre rasteve kur shlyerja bëhet në një këst të vetëm sipas nenit 4.01B, ku në këtë rast, në vend të saj, zbatohet dita pararendëse përkatëse e punës për shlyerjen e këstit të vetëm dhe për pagesën e interesit të fundit; dhe vetëm në këtë rast bëhet përshtatja me interesin e kërkueshëm sipas nenit 3.01; dhe

(ii) Për një transh të normës së ndryshueshme, dita pasuese, sipas rastit, e muajit kalendarik që është një ditë përkatëse pune ose në mungesë të saj, dita më e afërt pararendëse që është një ditë përkatëse pune, në të gjitha rastet me përshtatjen korresponduese me interesin e kërkueshëm sipas nenit 3.01.

“Shuma e parapagesës” është shuma e një transhi që duhet të parapaguhet nga huamarrësi në pajtim me nenin 4.02A.

“Data e parapagimit” është data, që është një datë pune, në të cilën Huamarrësi propozon të kryejë parapagesën e një shume parapagese.

“Njoftim parapagese” është një njoftim me shkrim nga huamarrësi që përcakton, ndërmjet të tjerash, shumën e parapagesës dhe datën e parapagesës në pajtim me nenin 4.02A.

“Projekti” ka kuptimin që i jepet në paragrafin hyrës (1).

“Shpenzim kualifikues” do të thotë shpenzimi (duke përfshirë koston e projektimit dhe mbikëqyrjes, sipas rastit, dhe pjesën neto të tatimeve dhe detyrimeve që paguhen nga Huamarrësi) të shkaktuara nga Huamarrësi për projektin, në lidhje me punët, mallrat dhe shërbimet në lidhje me artikujt e përcaktuar në përshkrimin teknik si të përshtatshme për financim në bazë të kredisë, që kanë qenë objekt i kontratës ose kontratave të nënshkruara sipas termave të pranueshëm për Bankën, duke pasur parasysh variantin më të fundit të udhëzimeve të prokurimit të Bankës, që është e publikuar në faqen e saj të internetit. Për qëllimin e llogaritjes së ekuivalentit në euro të një shume të shpenzuar në një monedhë tjetër, Banka zbaton normën e referencës së këmbimit të llogaritur dhe publikuar për atë monedhë nga Banka Europiane Qendrore në atë datë që bie pesëmbëdhjetë ditë (15) para datës së livrimit që caktohet nga Banka (ose në mungesë të një norme të tillë, norma ose normat përkatëse të këmbimit që mbizotërojnë në një treg financiar që zgjidhet në mënyrë të arsyeshme nga Banka).

“Norma e rivendosjes” është norma fikse në fuqi në ditën e llogaritjes së kompensimit për huat me interes fiks të përcaktuara në të njëjtën monedhë dhe që kanë të njëjtat terma për pagesën e interesit dhe të njëjtin profil shlyerjeje në datën e maturimit si shuma e parapagesës.

Për ato çështje, ku periudha është më e shkurtër se intervalet minimale të përshkruara sipas nenit 3.01, do të përdoret ekuivalenti i normës së tregut të parasë që përputhet më shumë, që është norma përkatëse ndërbankare minus 0.125% (12.5 pikë bazë) për periudha deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj. Për periudha që janë përkatësisht ndërmjet 13 dhe 36/48 muaj përkatësisht, zbatohet pika e ofertës për normat e këmbimit që publikohen nga InterCapital në Reuters për monedhën përkatëse dhe që respektohen nga Banka në momentin e llogaritjes.

“Ditë përkatëse biznesi” do të thotë:

iii) Për euron, një ditë që është ditë pune në pajtim me kalendarin e ditëve operative TARGET; dhe

iv) Për një monedhë tjetër, një ditë kur bankat janë të hapura për punë të përgjithshme në qendrën kryesore financiare të brendshme të monedhës përkatëse.

“Norma përkatëse ndërbankare” do të thotë:

1. EURIBOR-i për një transh të përcaktuar në euro;

2. LIBOR-i për një transh të përcaktuar në GBP ose USD; dhe

3. Norma e tregut dhe përkufizimi i saj, e zgjedhur nga Banka dhe e komunikuar veçmas Huamarrësit, për një transh të përcaktuar në një monedhë tjetër.

“Data e planifikuar e livrimit” është data në të cilën është planifikuar një transh për t'u livruar në pajtim me nenin 1.02C.

“Garanci” dhe “mjet i sigurimit të padisë”, është çdo hipotekë, peng, e drejtë pengu, barrë, transferim, hipotekim ose mjet sigurie padie apo një marrëveshje apo masë tjetër që ka efektin e dhënies së garancisë.

“*Spread*” është diferenca fikse te norma përkatëse ndërbankare (që është plus ose minus) e caktuar nga Banka dhe njoftuar Huamarrësit në njoftimin përkatës të disbursimit.

“Përshkrimi teknik” ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin hyrës (1).

“Transh” është çdo livrim i bërë ose që duhet të bëhet sipas kësaj kontrate.

Kështu bihet dakord si më poshtë:

Neni 1

Kredia dhe livrimi

1.01 Shuma e kredisë

Me këtë kontratë, Banka jep në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon kredinë në shumën 50 000 000 euro (pesëdhjetë milionë euro) për financimin e projektit (kredia).

1.02 Procedura e livrimit

1.02A Transhet

Banka e lëvront kredinë në deri 16 (gjashtëmbëdhjetë) transhe. Shuma e secilit transh, nëse nuk është gjendje e patërhequr e kredisë, është minimalisht 3 000 000 euro (tre milionë euro).

1.02B Kërkesa e livrimit

a) Herë pas here, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së fundit të disponibilitetit, Huamarrësi mund t’i paraqesë Bankës një kërkesë livrimi për livrimin e një transhi. Kërkesa e livrimit përcakton:

i) Shumën e transhit;

ii) Datën e preferuar të disbursimit për transhin, që është një ditë përkatëse pune që është të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas datës së kërkesës së livrimit dhe në ose para datës së fundit të disponibilitetit, ku është e kuptueshme që Banka mund të livrojë transhin deri në katër muaj kalendarikë nga data e kërkesës së livrimit;

iii) Nëse transhi është një transh me normë fikse ose një transh me normë të ndryshueshme, secila është në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit 3.01;

iv) Periodiciteti i pagesës së interesit të preferuar për transhin, i zgjedhur në pajtim me nenin 3.01;

v) Termat e preferuar të shlyerjes për principalin për transhin, të zgjedhur në pajtim me nenin 4.01;

vi) Datat e preferuara të para dhe të fundit për principalin e transhit; dhe

vii) Kodi IBAN (ose formati i përshtatshëm në pajtim me praktikën lokale bankare) dhe SWIFT BIC të llogarisë së bankës tek e cila duhet të bëhet livrimi i transhit në pajtim me nenin 1.02D;

b) Huamarrësi, në diskrecionin e tij, mund të përcaktojë gjithashtu në kërkesën e livrimit elementet e mëposhtme, sipas rastit, siç jepen nga Banka mbi bazë treguese dhe pa detyrim, që zbatohet për transhin, d.m.th.,

i) Në rastin e një transhi me normë fikse, normën fikse; dhe

ii) Në rastin e transhit me normë të ndryshueshme, *spread*-in. të zbatueshëm deri në datën e maturimit.

c) Nëse nuk është dhënë më parë, çdo kërkesë livrimi shoqërohet me prova të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar atë dhe ekzemplarët e firmave për këtë ose këta persona.

d) Në pajtim me nenin 1.02(b), çdo kërkesë livrimi është e parevokueshme.

1.02C Njoftim livrimi

a) Jo më pak se 10 (dhjetë) ditë para datës së planifikuar të propozuar të livrimit të një transhi, Banka, nëse kërkesa e livrimit është në pajtim me nenin 1.02, i jep Huamarrësit njoftimin e livrimit që përcakton:

- i) Shumën e transhit;
- ii) Datën e planifikuar për livrimin;
- iii) Bazën e normës së interesit për transhin;
- iv) Datën e parë të pagesës së interesit dhe periodicitetin për pagesën e interesit për transhin;
- v) Termat për shlyerjen e principalit për transhin;
- vi) Datat e para dhe të fundit për shlyerjen e principalit për transhin;
- vii) Datat e zbatueshme të pagesës për transhin;
- viii) Për një transh me normë fikse, normën fikse të interesit dhe për transhin e normës së ndryshueshme, *spread*-in.

b) Nëse një ose më shumë nga elementet e specifikuar në njoftimin e livrimit nuk reflektojnë elementin korrespondues, sipas rastit, në kërkesën e livrimit, Huamarrësi, pas marrjes së njoftimit të livrimit, mund të revokojë kërkesën e livrimit me njoftim me shkrim, drejtuar Bankës që duhet të merret jo më vonë se 12h00, sipas orës së Luksemburgut në ditën pasuese të punës dhe pas kësaj kërkesa e livrimit dhe njoftimi i disbursimit nuk ka efekt. Nëse Huamarrësi nuk ka revokuar me shkrim kërkesën e livrimit brenda kësaj periudhe, Huamarrësi konsiderohet të ketë pranuar të gjithë elementet e specifikuar në njoftimin e livrimit.

c) Nëse Huamarrësi i ka paraqitur Bankës një kërkesë livrimi në të cilën Huamarrësi nuk ka përcaktuar elementet e përmendura në nenin 1.02B (b), Huamarrësi konsiderohet të ketë rënë dakord paraprakisht me elementin korrespondues që përcaktohet më vonë në njoftimin e livrimit.

1.02D Llogaria e livrimit

Livrimi bëhet në llogarinë e Huamarrësit që Huamarrësi ia njofton me shkrim Bankës jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së planifikuar të livrimit (kodi IBAN ose me formatin e përshtatshëm në pajtim me praktikën bankare lokale).

Për çdo transh mund të përcaktohet vetëm një llogari.

1.03 Monedha e livrimit

Banka lëvront secilin transh në euro.

1.04 Kushtet e livrimit

1.04A Transhi i parë

Disbursimi i transhit të parë sipas nenit 1.02 është i kushtëzuar nga marrja nga Banka në formën dhe përmbajtjen e pranueshme për të, në ose para datës që bie 7 (shtatë) ditë pune para datës së planifikuar të livrimit, të dokumenteve ose provave të mëposhtme:

i) prova të pranueshme për Bankën, që nënshkrimi i kësaj kontrate nga Huamarrësi është autorizuar rregullisht dhe që personi ose personat që nënshkruajnë kontratën në emër të Huamarrësit janë autorizuar rregullisht për ta bërë këtë, së bashku me ekzemplarët e firmave të këtyre personave;

ii) një opinion ligjor të dhënë nga Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, që konfirmon se:

a) lidhja e kësaj kontrate dhe nënshkrimi i saj nga Ministri i Financave të Huamarrësit është autorizuar rregullisht dhe që personi që nënshkruan kontratën në emër të Huamarrësit është autorizuar rregullisht për ta bërë këtë, së bashku me ekzemplarët e firmave të këtij personi;

b) lidhja e kësaj kontrate dhe nënshkrimi nga Ministri i Financave të Huamarrësit është ratifikuar rregullisht me ligj të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

c) Huamarrësi ka lëshuar ose marrë të gjitha pëlqimet, autorizimet, licencat ose aprovimet e qeverisë, ose organeve publike, apo autoriteteve që kërkohen në lidhje me këtë kontratë;

d) Financimi i projektit futet në objektin e marrëveshjes kuadër;

e) Kontrata është tërësisht në fuqi, e vlefshme, detyruese dhe e ekzekutueshme në pajtim me termat e saj; dhe

f) Nuk ekzistojnë kufizime kontrolli dhe nuk kërkohet autorizim për të lejuar marrjen e të gjitha shumave që lëvrohen sipas kësaj në llogarinë e veçantë të përmendur në nenin 1.02D dhe që lejon shlyerjen e huas dhe pagesën e interesit dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj kontrate;

iii) Prova që Huamarrësi ka lëshuar ose përfutur të gjitha dokumentet e nevojshme, autorizimet, licencat ose aprovimet e organeve qeveritare apo publike ose autoriteteve që kërkohen në lidhje me projektin;

iv) Marrëveshja e huas e BERZH-it është nënshkruar dhe dhënë dhe të gjitha kushtet paraprake për fuqinë e saj ose të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje në bazë të saj janë përmbushur.

1.04B Të gjitha transhet

Livrimi i çdo transhi sipas nenit 1.02, duke përfshirë të parin, është i kushtëzuar nga:

a) Marrja nga Banka, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, në ose para datës që bie 7 (shtatë) ditë pune para datës së planifikuar të livrimit për transhin e propozuar, për dokumentet ose provat e mëposhtme:

i) një certifikatë nga Huamarrësi në formën e grafikut C.2;

ii) prova që tregojnë se, pas tërheqjes së transhit përkatës, shuma e plotë e kredisë së tërhequr nuk kalon shpenzimet e plota kualifikuese që janë përcaktuar në kontratë deri në datën e kërkesës përkatëse të livrimit;

iii) një kopje të çdo autorizimi tjetër apo dokumenti, mendimi ose garancie që Banka i ka bërë të ditur Huamarrësit është e nevojshme ose e dëshirueshme në lidhje me hyrjen dhe përmbushjen e veprimeve të parashikuara nga kontrata ose garancia ose për vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj;

iv) përveç transhit të parë, prova që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që Huamarrësi do të ketë shkaktuar, në ditën e 120-të pas datës së preferuar për livrimin e përcaktuar në kërkesën e livrimit, shpenzimet kualifikuese në një shumë të paktën të barabartë me shumën e plotë: i) 100% të shumave të të gjitha transheve të livruara; dhe ii) 80% të shumës së transheve që duhet të livrohen (100% të shumës së transhit, nëse ky transh është transhi i fundit që duhet të livrohet);

v) një plan i hollësishëm i prokurimit për secilin transh, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

vi) prova që autoriteti kompetent mjedisor ka kontrolluar çdo skemë që duhet të financohet nga transhi përkatës dhe që procedura përkatëse EIA, sipas parashikimit nga ligji vendas është ndërmarrë dhe rekomandimet përkatëse janë përfshirë në planet përkatëse të menaxhimit;

vii) prova që autoriteti kompetent për konservimin e natyrës ka përcaktuar nëse një skemë që financohet nga transhi përkatës ka potencialin e një ndikimi thelbësor për një zonë të mbrojtur (formulari A/B ekuivalenti);

viii) prova ose deklarament që dispozitat e kuadrit të politikës së rishlyerjes të datës 19 mars, 2008 janë zbatuar në të gjitha skemat që financohen nga transhi përkatës.

b) Që në datën e planifikuar të livrimit për transhin e propozuar:

i) përfaqësimet dhe garancitë që përsëriten në pajtim me nenin 6.08 janë të sakta në të gjitha aspektet;

ii) asnjë ngjarje ose rrethanë që përbën ose do të përbënte me kalimin e kohës ose dhënies së njoftimit në bazë të kësaj kontrate një ngjarje të qenies në vonesë sipas nenit 10.01 ose një ngjarje parapagimi sipas nenit 4.03 ka ngjarë dhe po vazhdon pa u korrigjuar ose hequr dorë ose do të rezultonte nga transhi i propozuar;

c) Që Banka ka dhënë “moskundërshtimin” e saj për listën e skemave që financohen sipas transhit përkatës.

1.05 Shtyrja e livrimit

1.05A Shkaqet e shtyrjes

Me kërkesë me shkrim të Huamarrësit, Banka shtyn livrimin e çdo transhi të njoftuar plotësisht ose pjesërisht deri në një datë të përcaktuar nga Huamarrësi që është një datë që është jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e planifikuar e livrimit. Në këtë rast, Huamarrësi paguan zhdëmtimin e shtyrjes sipas përcaktimit në pajtim me nenin 1.05B më poshtë.

Çdo kërkesë për shtyrje ka efekt në lidhje me një transh vetëm nëse bëhet të paktën 7 (shtatë) ditë pune para datës së planifikuar të livrimit.

Nëse një nga kushtet e përmendura në nenin 1.04 nuk përmbushet në datën e përcaktuar dhe në datën e planifikuar të livrimit, Banka është e mendimit që nuk bindet, livrimi shtyhet deri në një datë të rënë dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit që nuk bie më parë se 7 (shtatë) ditë pune pas përmbushjes të të gjitha kushteve të disbursimit.

1.05B Zhdëmtimi për shtyrjen

Nëse livrimi i një transhi të njoftuar shtyhet, qoftë me kërkesë të Huamarrësit apo për shkak të mospërmbushjes së kushteve të livrimit, Huamarrësi, me kërkesë të Bankës, i paguan një zhdëmtim për shumën e livrimit të shtyrë. Ky zhdëmtim mblihet nga data e planifikuar e livrimit deri në datën faktike të livrimit, ose, sipas rastit, deri në datën e anulimit të Transhit të njoftuar në pajtim me kontratën me një normë të barabartë me R_1 minus R_2 , ku:

“ R_1 ” është norma e interesit që do të ishte zbatuar herë pas here në pajtim me nenin 3.01 dhe, nëse transhi është livruar në datën e planifikuar të livrimit; dhe

“ R_2 ” është norma përkatëse ndërbankare më pak se 0.125% (12.5 pikë bazë); me kusht që qëllimi i përcaktimit të normës përkatëse ndërbankare në lidhje me këtë nen 1.05, periudhat përkatëse të parashikuara në grafikun B janë periudha pasuese prej 1 (një) muaji që fillon në datën e planifikuar të livrimit.

Për më tepër, zhdëmtimi:

- i) nëse shtyrja kalon një (1) muaj në kohëzgjatje, mblihet në fund të çdo muaji;
- ii) llogaritet duke përdorur mënyrën e llogaritjes së ditëve të zbatueshme për R_1 ;
- iii) nëse R_2 kalon R_1 , caktohet në zero; dhe
- iv) është i pagueshëm në pajtim me nenin 1.10.

1.05C Anulimi i livrimit të shtyrë me 6 (gjashtë) muaj

Banka, me njoftim drejtuar Huamarrësit, anulon livrimin që është shtyrë në pajtim me nenin 1.05A për më shumë se 6 (gjashtë) muaj në tërësi. Shuma e anuluar mbetet e disponueshme për livrim sipas nenit 1.02.

1.06 Anulimi dhe pezullimi

1.06A E drejta e Huamarrësit për anulim

Huamarrësi në çdo kohë, me njoftim me shkrim drejtuar Bankës, mund të anulojë, plotësisht ose pjesërisht dhe me efekt të menjëhershëm, pjesën e palivruar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk ka efekt në lidhje me një transh të njoftuar që ka një datë të planifikuar të livrimit që bie brenda 5 (pesë) ditëve të punës nga data e njoftimit.

1.06B E drejta e Bankës për pezullim dhe anulim

i) Banka, me njoftim me shkrim drejtuar Huamarrësit pezullon dhe/ose anulon pjesën e palivruar të kredisë plotësisht ose pjesërisht, në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm:

a) me ndodhinë e një ngjarjeje ose rrethane të përmendur në nenin 10.01 ose një ngjarjeje apo rrethane që me kalimin e kohës ose dhënien e njoftimit sipas kësaj kontrate përbënte një ngjarje të qenies në vonesë sipas nenit 10.01;

b) nëse ka ndodhur një ngjarje e deformimit të tregut dhe nuk ka pushuar; ose

c) nëse, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, nuk është e bindur që garancitë dhe detyrimet e marra përsipër nga Huamarrësi në nenet 6 dhe 8.04 janë përmbushur.

ii) Për më tepër, në masën që Banka mund të anulojë kredinë sipas nenit 4.03A, Banka mund edhe ta pezullojë atë. Çdo pezullim vazhdon deri sa Banka përfundon pezullimin ose anulon shumën e pezulluar.

iii) Për qëllimet e këtij neni, “ngjarje e deformimit të tregut” do të thotë:

a) Banka përcakton që ka rrethana të veçanta me efekt negativ për aksesin e Bankës te burimet e saj të financimit;

b) sipas mendimit të Bankës, kostoja për Bankën për përfitim të fondeve nga burimet e saj të financimit do të ishte tej normës së zbatueshme përkatëse ndërbankare për monedhën përkatëse dhe periudhën e transhit;

c) Banka përcakton që për shkak të rrethanave që ndikojnë në burimet e financimit përgjithësisht nuk ekzistojnë mjete të përshtatshme dhe të drejta për të pohuar normën e zbatueshme përkatëse ndërbankare për monedhën përkatëse dhe periudhën e transhit;

d) sipas mendimit të Bankës fondet nuk mund të jenë normalisht disponibël në rrjedhën normale të punës për të financuar një transh në monedhën e kërkuar ose për periudhën përkatëse, nëse është e zbatueshme dhe e përshtatshme për operimin përkatës të huadhënies; ose

e) nuk është e mundur për Bankën të marrë financim në shumën e mjaftueshme për të financuar një livrim, nëse është e zbatueshme dhe e përshtatshme për operimin përkatës të huadhënies, ose ka një ndryshim material në borxhin ndërkombëtar, tregun e parasë ose kapitalin.

1.06C Zhdëmtimi për pezullimin dhe anulimin e një transhi

1.06C(1) Pezullimi

Nëse Banka pezullon një transh të njoftuar, qoftë pas një ngjarjeje të parapagesës të zhdëmtueshme ose në ngjarjen e përmendur në nenin 10.01, Huamarrësi zhdëmton Bankën sipas nenit 1.05B.

1.06C(2) Anulimi

Në pajtim me nenin 1.06A, nëse Huamarrësi anulon:

i) Një transh të njoftuar me normë fikse, ai zhdëmton Bankën sipas nenit 4.02B;

ii) Një transh të njoftuar me normë të ndryshueshme ose një pjesë e kredisë e ndryshme nga një transh i njoftuar, nuk paguhet asnjë zhdëmtim.

Nëse Banka anulon një transh të njoftuar me normë fikse pas një ngjarjeje parapagesë të zhdëmtueshme ose në pajtim me nenin 1.05C, Huamarrësi zhdëmton Bankën sipas nenit 4.02B. Nëse Banka anulon një transh të njoftuar pas një ngjarjeje të përmendur në nenet 10.01 ose 10.02, Huamarrësi zhdëmton Bankën sipas nenit 10.03. Përveç këtyre rasteve, asnjë zhdëmtim nuk paguhet pas anulimit të një transhi nga Banka.

Një zhdëmtim llogaritet mbi bazën që shumën e anuluar konsiderohet të jetë livruar dhe shlyer në datën e planifikuar të livrimit, ose në masën që livrimi i transhit faktikisht shtyhet ose pezullohet në datën e njoftimit të anulimit.

1.07 Anulimi pas skadimit të kredisë

Çdo moment pas skadimit të një periudhe prej 4 (katër) muaj pas datës përfundimtare të disponibilitetit, Banka, me njoftim drejtuar Huamarrësit dhe pa asnjë detyrim për asnjë palë, mund të anulojë pjesën e kredisë në lidhje me të cilën nuk është bërë asnjë kërkesë livrimi në pajtim me nenin 1.02B.

1.08 Shumat e kërkueshme sipas nenit 1

Shumat e kërkueshme në pajtim me nenet 1.05 dhe 1.06 paguhen në euro. Ato paguhen brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja prej Huamarrësit të kërkesës së Bankës ose brenda një afati më të gjatë që përcaktohet në kërkesën e Bankës.

Neni 2

Huaja

2.01 Shuma e huas

Huaja përbëhet nga shumën e plota të transheve të livruara nga Banka sipas kredisë, që konfirmohet nga Banka në pajtim me nenin 2.03

2.02 Monedha e shlyerjes, interesit dhe detyrimeve të tjera

Interesi, shlyerjet dhe detyrimet e tjera që paguhen në lidhje me çdo transh bëhen nga Huamarrësi në euro.

Çdo pagesë tjetër bëhet në monedhën e përcaktuar nga banka duke pasur parasysh monedhën e shpenzimeve që rimbursohen nëpërmjet pagesës.

2.03 Konfirmimi nga Banka

Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas livrimit të secilit transh, Banka i dërgon Huamarrësit tabelën e amortizimit të përmendur në nenin 4.01, sipas rastit, duke treguar datën e livrimit, monedhën, shumën e livruar, termat e shlyerjes dhe normën e interesit për atë transh.

Neni 3 Interesi

3.01 Norma e interesit

Normat fikse dhe *spread* ofrohen për periudha jo më të shkurtra se 4 (katër) vjet ose, në mungesë të një shlyerjeje të principalit gjatë asaj periudhe, jo më pak se 3 (tre) vjet.

3.01A Transhet me normë fikse

Huamarrësi paguan interes për balancën e mbetur për çdo transh me normë fikse në çdo tre muaj, dy herë në vit ose çdo vit në fund të periudhës në datat përkatëse të pagesës, që përcaktohet në njoftimin e livrimit, duke filluar në datën e parë të tillë të pagesës pas datës në të cilën është bërë livrimi i transhit. Nëse periudha nga data në të cilën është bërë livrimi te data e parë e pagesës është 15 ditë ose më pak, pagesa e interesit të mbledhur gjatë kësaj periudhe shtyhet deri në datën pasuese të pagesës.

Interesi llogaritet mbi bazën e nenit 5.01(i) në një normë vjetore që është norma fikse.

3.01B Transhet me normë të ndryshueshme

Huamarrësi paguan interes për balancën e mbetur për çdo transh me normë të ndryshueshme çdo tre muaj, dy herë në vit ose çdo vit në fund të periudhës në datat përkatëse të pagesës, që përcaktohet në njoftimin e livrimit, duke filluar në datën e parë të tillë të pagesës pas datës në të cilën është bërë livrimi i transhit. Nëse periudha nga data në të cilën është bërë livrimi te data e parë e pagesës është 15 ditë ose më pak, pagesa e interesit të mbledhur gjatë kësaj periudhe shtyhet deri në datën pasuese të pagesës.

Banka i njofton Huamarrësit normën e ndryshueshme të zbatueshme për një transh me normë të ndryshueshme në lidhje me çdo periudhë reference të normës së ndryshueshme brenda dhjetë (10) ditëve pas fillimit të kësaj periudhe reference të normës së ndryshueshme.

Nëse në pajtim me nenet 1.05 dhe 1.06, livrimi i çdo transhi me normë të ndryshueshme kryhet pas datës së livrimit të planifikuar, norma e interesit të zbatueshëm për periudhën e referencës me normë të ndryshueshme përcaktohet sikur livrimi të ishte kryer në datën e planifikuar të livrimit.

Interesi për një transh me normë të ndryshueshme llogaritet në lidhje me çdo periudhë reference të normës së ndryshueshme në bazë të nenit 5.01(ii).

3.02 Interesi për shumat e vonuara

Pavarësisht nga neni 10 dhe nëpërmjet një përjashtimi të nenit 3.01, interesi mblihet për çdo shumë të papaguar dhe që duhet të paguhet në pajtim me termat e kësaj kontrate nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës me një normë vjetore të barabartë me normën përkatëse ndërbankare plus 2% (200 pikë bazë) dhe është e pagueshme në pajtim me kërkesën e Bankës. Për qëllimin e caktimit të normës përkatëse ndërbankare në lidhje me këtë nen 3.02, periudhat përkatëse brenda kuptimit të grafikut B do të jenë periudha pasuese të një muaji që fillon në datën e kërkueshme.

Megjithatë, interesi për një transh me normë fikse vendoset në një normë vjetore që është shuma e normës së përcaktuar në nenin 3.01A plus 0.25% (25 pikë bazë) nëse ajo normë vjetore kalon, për një periudhë të caktuar kohe, normën e përcaktuar në paragrafin e mësipërm.

Nëse shuma e vonuar është në një monedhë të ndryshme nga monedha e huas, zbatohet norma e mëposhtme në vit, që është norma përkatëse ndërbankare që ruhet përgjithësisht nga Banka për veprimet në monedhën plus 2% (200 pikë bazë), të llogaritur në pajtim me praktikën e tregut të kësaj norme.

Neni 4 Shlyerja

4.01 Shlyerja normale

4.01A Shlyerja me këste

a) Huamarrësi shlyen çdo transh me këste në datat e pagesës të përcaktuara në njoftimin përkatës të livrimit në pajtim me termat dhe tabelës së amortizimit të dhënë në pajtim me nenin 2.03.

b) Çdo tabelë amortizimi tërhiqet mbi bazën që:

i) në rastin e një transhi me normë fikse, shlyerja bëhet në një bazë konstante vjetore ose këste të barabarta vjetore, gjashtëmujore ose tremujore të principalit;

ii) në rastin e një transhi me normë të ndryshueshme, shlyerja bëhet me këste të barabarta vjetore, gjashtëmujore ose tremujore të principalit; dhe

iii) data e parë e shlyerjes të çdo transhi është një datë pagese që bie jo më vonë se data e parë e pagesës menjëherë pas përvjetorit të pestë të datës së planifikuar të livrimit të transhit dhe data e fundit e shlyerjes do të jetë data e pagesës që nuk është më parë se 4 (katër) vjet dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet nga data e planifikuar e livrimit.

4.01B Kësti i vetëm

Si alternativë, Huamarrësi mund të shlyejë transhin në një këst të vetëm në një datë pagese të përcaktuar në njoftimin e shlyerjes, që është një datë që bie jo më pak se 3 (tre) vjet ose më shumë se 10 (dhjetë) vjet nga data e planifikuar e livrimit.

4.02 Parapagesa vullnetare

4.02A Opsioni i parapagesës

Në pajtim me nenet 4.02B, 4.02C dhe 4.04, Huamarrësi mund të parapaguajë të gjithë ose një pjesë të një transhi së bashku me interesin e mbledhur dhe zhdëmtimet, sipas rastit, me bërjen e një njoftimi parapagimi me të paktën një njoftim 1-(një) mujor, duke përcaktuar shumën e parapagesës dhe datën e parapagesës.

Në pajtim me nenin 4.02C, njoftimi i parapagesës është detyrues dhe i parevokueshëm.

4.02B Zhdëmtimi për parapagesën

4.02B(1) Transhi me normë fikse

Për një parapagim të bërë në një datë pagese, Huamarrësi i paguan Bankës në datën e parapagesës një zhdëmtim të barabartë me vlerën e tashme (që nga data e parapagesës) të shtesës, sipas rastit:

i) të interesit që do të mblidhej pas kësaj në shumën e parapagesës gjatë periudhës nga data e parapagesës deri në datën e maturimit, nëse nuk është parapaguar; ose

ii) të interesit që do të mblidhej gjatë asaj periudhe, nëse do të llogaritej në datën e rivendosjes, minus 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë).

Vlera e tashme e lartpërmendur llogaritet në një normë skontoje të barabartë me normën e rivendosjes, të zbatuar për çdo datë përkatëse të pagesës.

4.02B(2) Transhi me normë të ndryshueshme

Huamarrësi mund të parapaguajë një transh me normë të ndryshueshme pa zhdëmtim në çdo datë përkatëse të pagesës.

4.02C Mënyra e parapagimit

Banka njofton Huamarrësin, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së shlyerjes së shumës së parapagesës, interesin e mbledhur të kërkuar për të dhe zhdëmtimin e kërkueshëm në pajtim me nenin 4.02B ose, sipas rastit, që nuk është i kërkueshëm asnjë zhdëmtim.

Jo më vonë se afati i pranueshmërisë, Huamarrësi njofton Bankën që:

- i) ai konfirmon njoftimin e parapagesës për termat e specifikuar nga Banka; ose
- ii) që ai tërheq njoftimin e parapagesës.

Nëse Huamarrësi jep konfirmimin sipas (i), ai kryen parapagimin. Nëse Huamarrësi tërheq njoftimin e parapagesës ose nuk konfirmon ata në kohën e duhur, ai nuk mund të bëjë parapagimin. Përveç sa më sipër, njoftimi i parapagimit është detyrues dhe i parevokueshëm.

Huamarrësi shoqëron parapagesën me pagesën e interesit të mbledhur dhe zhdëmtimin, sipas rastit, të kërkueshëm për shumën e parapagimit.

4.03 Parapagimi i detyruar

4.03A Shkaqet për parapagim

4.03A(1) Ulja e kostos së projektit

Nëse kostoja totale e projektit duhet të zbritet nga shifra e caktuar në paragrafin hyrës (2) në një nivel në të cilin shumata e kredisë kalon 50% (pesëdhjetë për qind) të kësaj kostoje, Banka, në raport me zbritjen, nëpërmjet njoftimit drejtuar Huamarrësit, mund të anulojë menjëherë kredinë dhe të kërkojë shlyerjen e huas.

4.03A(2) *Pari passu* ndaj një huaje tjetër me afat

Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht një pjesë ose të gjithën e një huaje tjetër që i është dhënë fillimisht atij për një afat më shumë se 3 (tre) vjet (hua me afat) të ndryshme nga shumata e huas që kanë një afat të paktën të barabartë me afatin e paskaduar të huas me afat të parapaguar, Banka, nëpërmjet njoftimit drejtuar Huamarrësit, mund të anulojë kredinë dhe të kërkojë parapagimin e huas, në atë raport që shumata e parapaguar e huas me afat ka me shumën e plotë të mbetur të të gjithë huave me afat.

Banka ia drejton njoftimin e saj Huamarrësit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit sipas nenit 8.02.

Për qëllimet e këtij neni, “huaja” përfshin çdo hua, detyrim ose formë tjetër të borxhit financiar ose çdo detyrim për pagesën ose shlyerjen e parave.

4.03A(3) Ndryshimi i ligjit

Huamarrësi informon menjëherë Bankën nëse një ngjarje për ndryshimin e ligjit (siç përcaktohet më vonë) ka ndodhur ose mund të ketë ndodhur në lidhje me Huamarrësin ose, nëse Banka ka shkak të arsyeshëm për të besuar që një ngjarje e ndryshimit të ligjit ka ndodhur ose mund të ndodhë, Banka mund të kërkojë që Huamarrësi të konsultohet me të. Këto konsultime zhvillohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e kërkesës së bankës. Pas kohës më të hershme nga: i) kalimi i 30 (tridhjetë) ditëve nga data e kësaj kërkesë për konsultime; ose ii) ndodhia e ngjarjes së ndryshimit të ligjit, Banka, nëpërmjet njoftimit drejtuar Huamarrësit, anulon kredinë dhe kërkon parapagimin e huas, së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumata e tjera të mbledhura të kërkueshme në datën e përcaktuar nga Banka, ku kjo datë është data që bie jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

Për qëllimet e këtij neni “ngjarje e ndryshimit të ligjit” është miratimi, shpallja, nënshkrimi ose ratifikimi i një ndryshimi apo amendimi në ligj, rregull ore rregullore (ose në zbatim të interpretimit zyrtar të ligjit, rregullit apo rregullores) që ndodh pas datës së kësaj kontrate që sipas mendimit të bankës rezulton ose është e mundur të rezultojë në një ndryshim material negativ.

4.03A(4) Shpenzimi kualifikues më i vogël se shumata e transhit

Huamarrësi:

a) brenda 120 ditëve pas livrimit të një transhi, kryen shpenzimet kualifikuese në një shumë që është të paktën e barabartë me shumën totale të 80% të shumës së atij transhi dhe 100% të shumave të transheve të livruara para saj, sipas rastit.

b) brenda 120 ditëve pas livrimit të transhit të fundit, kryen shpenzimet kualifikuese në një shumë që është të paktën e barabartë me shumën totale prej 100% të shumës së atij transhi dhe 100% të shumave të transheve të livruara para saj, sipas rastit;

Si provë e respektimit të detyrimeve të mësipërme, Huamarrësi paraqet, në një mënyrë të pranueshme për Bankën, dokumentet në gjuhën angleze ose të shoqëruara nga një përkthim në gjuhën angleze.

Nëse në lidhje me një transh të livruar, Huamarrësi nuk i paraqet Bankës ndonjë dokument të përmendur në këtë nen 4.03A(4) në datat përkatëse të kërkueshme, Banka mund të kërkojë parapagimin e pjesës së transhit që kalon shumë e shpenzimeve kualifikuese që janë shkaktuar nga Huamarrësi në lidhje me të cilat Huamarrësi ka paraqitur prova të pranueshme për Bankën.

4.03B Mënyra e parapagimit

Çdo shumë e kërkuar nga Banka në pajtim me nenin 4.03A, së bashku me një interes ose shuma të tjera të mbledhura dhe të papaguara dhe çdo zhdëmtim të kërkueshëm në pajtim me nenin 4.03C, paguhet në datën e treguar nga Banka dhe kjo datë bie jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e njoftimit të Bankës së kërkesës dhe zbatohet në pajtim me nenin 10.05.

4.03C Zhdëmtimi për parapagim

Në rastin e një ngjarjeje të parapagimit të zhdëmtueshëm, zhdëmtimi, sipas rastit, përcaktohet në pajtim me nenin 4.02B për një transh në normë fikse.

Nëse, përveç kësaj, në pajtim me një dispozitë të nenit 4.03A, Huamarrësi parapaguan një transh në një datë të ndryshme nga një datë përkatëse e pagesës, Huamarrësi zhdëmton bankën në atë shumë që Banka vërteton si të nevojshme për të kompensuar ata për marrjen e fondeve jo në një datë përkatëse të pagesës.

4.04 Zbatimi i parapagesave të pjesëshme

Nëse Huamarrësi parapaguan pjesërisht një transh, shuma e parapagimit zbatohet proporcionalisht për çdo këst të paguar.

Një shumë e parapaguar nuk mund të rimerret hua. Ky nen 4 nuk cenon nenin 10.

Neni 5 Pagesat

5.01 Mënyra e llogaritjes së ditëve

Çdo shumë e kërkueshme për shkak të interesit, zhdëmtimit ose një tarife nga Huamarrësi në bazë të kësaj kontrate dhe e llogaritur në lidhje me një pjesë të vitit, përcaktohet në përcaktimet e mëposhtme përkatëse:

- i) Për një transh të normës fikse, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe një muaj me 30 (tridhjetë) ditë; dhe
- ii) Për një transh me normë të ndryshueshme, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe numri i ditëve të kaluara.

5.02 Koha dhe vendi i pagesës

Përveç kur përcaktohet ndryshe, të gjitha shumat e ndryshme nga interesi, zhdëmtimi dhe principal paguhen brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e Huamarrësit të kërkesës së Bankës.

Çdo shumë e pagueshme nga Huamarrësi në bazë të kësaj kontrate derdhet në llogarinë përkatëse të njoftuar nga Banka Huamarrësit. Banka tregon llogarinë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së kërkueshme për pagesën e parë nga Huamarrësi dhe njofton çdo ndryshim të llogarisë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së pagesës së parë për të cilën zbatohet ndryshimi. Kjo periudhë njoftimi nuk zbatohet në rastin e pagesës sipas nenit 10.

Një shumë e kërkueshme nga Huamarrësi konsiderohet e paguar kur merret nga Banka.

5.03 Kompensimi

Banka mund të përfitojë kompensimin për çdo detyrim të maturuar të kërkueshëm prej Huamarrësit sipas kontratës financiare (në masën që është në pronësi të Bankës) ndaj çdo detyrimi (qoftë i maturuar apo jo) në pronësi të Bankës ndaj Huamarrësit, pavarësisht vendit të pagesës, degës së regjistrimit apo monedhës së një detyrimi. Nëse detyrimet janë në monedha të ndryshme, Banka mund të konvertojë detyrimin me normën e tregut të këmbimit në vazhden e zakonshme të

biznesit për qëllimin e kompensimit. Nëse një detyrim është i palikuiduar ose i pakonstatuar, Banka mund të kompensojë në një shumë që vlerësohet prej saj në mirëbesim sikur është shuma e atij detyrimi.

Neni 6

Detyrimet dhe përfaqësimet e Huamarrësit

Detyrimet sipas nenit 6 mbeten në fuqi nga data e kësaj kontrate për sa kohë një shumë është e papaguar në bazë të kësaj kontrate ose që kredia është në fuqi.

6.01 Përdorimi i huas dhe disponibiliteti i fondeve të tjera

Huamarrësi i përdor shumat e huas vetëm për ekzekutimin e projektit.

Huamarrësi siguron që ka në dispozicion të gjitha fondet e tjera të renditura në paragrafin hyrës (2) dhe që këto fonde shpenzohen, në masën që është e nevojshme, për financimin e projektit.

6.02 Përfundimi i projektit

Huamarrësi merr masa që nxitësi të sigurojë që projekti të kryhet në pajtim me përshkrimin teknik që mund të ndryshohet herë pas here me aprovimin e Bankës, dhe që do të përfundohet në datën e përcaktuar në të.

6.03 Kostoja e shtuar e projektit

Nëse kostoja totale e projektit e kalon shifrën e vlerësuar të përcaktuar në paragrafin hyrës (2), Huamarrësi merr financim për të mbuluar koston shtesë pa iu drejtuar Bankës, në mënyrë që të mundësojë projektin të përfundohet në pajtim me përshkrimin teknik. Planet e financimit të koston shtesë i komunikohen Bankës pa vonesë.

6.04 Procedura e prokurimit

Huamarrësi garanton që zbatuesi të blejë pajisjet, të sigurojë shërbimet dhe të autorizojë punët për projektin në pajtim me planin e prokurimit që duhet të miratohet nga Banka, që ndryshohet herë pas here pas marrëveshjes ndërmjet Bankës dhe zbatuesit, me tender ndërkombëtar të hapur ose procedura të tjera të pranueshme prokurimi që përputhen, sipas bindjes së Bankës, me politikën e saj të përshkruar në udhëzimin për prokurimin që është në fuqi në datën e kësaj kontrate.

6.05 Detyrimet e vazhdueshme të projektit

Huamarrësi merr masa që zbatuesi, Autoriteti Shqiptar i Rrugëve, ose organet e pushtetit lokal, sipas rastit:

i) Mirëmbajtja: mirëmbajnë, riparojnë, përmirësojnë ose rinovojnë të gjithë pasurinë që është pjesë e projektit që kërkohet për ta mbajtur atë në gjendje të mirë pune;

ii) Sendet pasurore të projektit: përveç kur Banka jep pëlqimin e saj me shkrim, ruan të drejtën dhe zotërimin e të gjithë ose kryesisht të gjitha sendeve pasurore që përbëjnë projektin ose, sipas rastit, zëvendëson dhe rinovon këto sende pasurore dhe mirëmban projektin në operim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm në pajtim me qëllimin fillestar; me kusht që Banka të mund të mos e japë pëlqimin vetëm nëse veprimi i propozuar do të cenonte interesat e Bankës si Huadhënës për Huamarrësin ose do ta bënte projektin të papërshtatshëm për financimin nga Banka sipas statutit të tij ose sipas nenit 309 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian;

iii) Sigurimi: siguron të gjitha punët dhe pronat që përbëjnë pjesë të projektit dhe nga shoqëri sigurimi të klasës së parë, në pajtim me praktikat më të plota të industrisë përkatëse;

iv) Të drejtat dhe lejet: mban në fuqi të gjitha të drejtat e kalimit dhe përdorimit dhe të gjitha lejet e nevojshme për ekzekutimin dhe operimin e projektit; dhe

v) Mjedisi: zbaton dhe operon projektin në pajtim me ligjin mjedisor dhe siguron:

a) marrjen e lejeve mjedisore dhe lejet e planifikimit, si dhe kur është e nevojshme për realizimin e projektit;

b) respektimin me çdo përshkrim të dhënë dhe kusht që i bashkëngjitet çdo pëlqimi apo miratimi;

c) respektim në realizimin dhe operimin e projektit, me legjislacionin mjedisor, herë pas here të zbatueshëm;

d) zbatimin e të gjithë komponentëve të projektit në pajtim me rekomandimet e EIA-s dhe lejet përfundimtare nga autoritetet përkatëse mjedisore.

vi) Ligji i BE-së: ekzekuton dhe operon projektin në pajtim me standardet përkatëse të ligjit të BE-së në masën që zbatohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë ose të përcaktuar nga Banka para datës së kontratës.

6.06 Detyrime të tjera

Huamarrësi:

a) siguron që zbatuesi të ketë kompetencën të zbatojë projektin dhe që gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të projektit të ketë personel të mjaftueshëm dhe burime financiare të mjaftueshme (duke përfshirë asistencë teknike) për të lejuar përmbushjen e detyrave të tij, përgjegjësi dhe detyrimeve në lidhje me projektin në një mënyrë të efektshme;

b) transferon të drejtat për administrimin e rrugëve rajonale nga këshillat rajonale tek Autoriteti Shqiptar i Rrugëve jo më vonë se data 31 dhjetor 2013.

c) bën që zbatuesi të sigurojë që:

i) të gjitha skemat e financuara nga projekti të zbatohen në pajtim me kuadrin e garancive për mjedisin të aprovuar nga Banka Botërore, të datës 10 mars 2008 që mund të ndryshohet herë pas here në marrëveshje me Bankën;

ii) të gjitha skemat e financuara nga projekti të zbatohen në pajtim me kuadrin e politikës së rivendosjes të datës 19 mars 2008, që mund të ndryshohen herë pas here në marrëveshje me Bankën;

iii) nëse nevoja për një plan veprimi rivendosjeje lind për një skemë të financuar nga projekti, ky plan përgatitet në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën dhe zbatohet nga autoritetet përkatëse, në pajtim me një grafik që bihet dakord me Bankën;

iv) për ato skema të financuara nga projekti që mund të rezultojnë në një ndikim të konsiderueshëm për një zonë apo specie të mbrojtur ndërkombëtarisht, EIA-ja përkatëse do të përgatitet në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

d) siguron që zbatuesi:

i) para dhënies së kontratës për punët përkatëse të rehabilitimit, lidh një marrëveshje mirëmbajtjeje dhe operacionale me organin përkatës të pushtetit lokal, të pranueshëm në të gjitha aspektet për Bankën, për të gjitha skemat e rrugëve lokale të financuara në bazë të kësaj;

ii) siguron mirëmbajtjen dhe përditësimin e inventarit të sendeve pasurore dhe sistemin e menaxhimit për të gjitha rrugët komunale;

iii) publikon në faqen e tij të internetit rezultatet e procesit të përzgjedhjes së skemës me të paktën bazë vjetore dhe përparimin fizik dhe financiar të të gjitha skemave të kontraktuara të financuara sipas kësaj me të paktën bazë tremujore;

iv) të paktën çdo dy vjet, publikon në faqen e tij të internetit sistemin e gjendjes së rrjetit për të gjitha rrugët e komunës;

v) lehtëson, në masën e mundur, për organet e pushtetit lokal në ndërmarrjen e mirëmbajtjes së rrugëve komunale të rehabilituara.

6.07 Respektimi i ligjeve

Huamarrësi siguron që zbatuesi të respektojë në të gjitha aspektet ligjet, të cilave u nënshtrohet ai ose projekti.

6.08 Përfaqësime dhe garanci të përgjithshme

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton para Bankës që:

i) Ai ka kompetencën të nënshkruajë, japë dhe përmbushë detyrimet sipas kësaj kontrate dhe që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e këtyre prej tij;

ii) Kjo kontratë përbën detyrimet e tij ligjërish të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme;

iii) Nënshkrimi dhe dhënia, si dhe përmbushja e detyrimeve të tij në bazë të dhe në pajtim me dispozitat e kësaj kontrate nuk dhe:

a) nuk do të bien në kundërshtim apo në konflikt me ndonjë ligj, statut, rregull apo rregullore të zbatuar, apo ndonjë vendim, dekret ose leje që ai i nënshtrohet;

b) nuk do të bien në kundërshtim apo në konflikt me një marrëveshje ose instrument tjetër që është detyrues për të që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ketë ndikim negativ në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet në pajtim me këtë kontratë;

c) nuk do të bien në kundërshtim ose konflikt me ligjet ose rregulloret që janë detyruese për të.

iv) Nuk ka pasur ndryshim material negativ;

v) Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje ose rrethanë që përbën një ngjarje të qenies në vonesë në pajtim me nenin 10.01 dhe nuk vazhdon e pakorrigjuar apo pa hequr dorë;

vi) Nuk ka nisur asnjë gjykim arbitrazhi apo procedim administrativ, apo hetim, apo që sipas informacioneve të tij mund të fillojë para një gjykate, gjykate arbitrazhi apo agjencie që ka rezultuar, apo që nëse vendoset negativisht mund të rezultojë në një ndryshim material negativ, dhe kundër tij apo filialeve të tij nuk ka ndonjë vendim negativ gjykate apo arbitrazhi;

vii) Ai ka lëshuar ose marrë të gjitha pëlqimet, autorizimet, licencat ose aprovimet e nevojshme të organeve qeveritare ose publike apo autoriteteve në lidhje me këtë kontratë dhe projektin dhe të gjitha këto pëlqime, autorizime, licenca ose aprovime janë tërësisht në fuqi dhe të pranueshme si provë;

viii) Është pronari i vetëm ligjor dhe përfitues dhe ka të drejtë të plotë për sendet pasurore në lidhje me projektin në datën e kësaj kontrate, nuk ekziston asnjë barrë mbi sendet e tij pasurore; dhe

ix) Detyrimet e tij për pagesën në bazë të kësaj kontrate nuk janë më pak se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhme, të pasiguruara dhe të varura sipas çdo instrumenti borxhi përveç se detyrimet që preferohen në mënyrë të detyrueshme me ligj ose zbatim të përgjithshëm.

Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara më sipër ekzistojnë edhe pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe konsiderohen të përsëriten në çdo datë të planifikuar livrimi dhe çdo datë pagese.

6.09 Detyrimi i integritetit

i) Huamarrësi garanton dhe merr përsipër që nuk ka kryer dhe asnjë person sipas njohurive të tij të tashme nuk ka kryer një prej veprimeve të mëposhtme dhe që nuk do të kryejë dhe asnjë person, me pëlqimin dhe dijen paraprake të tij, nuk do të kryejë asnjë veprim të tillë, që janë:

a) ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi i një avantazhi të parregullt për të ndikuar veprimin e një personi që ka një funksion publik ose post publik apo një drejtor apo të punësuar të një autoriteti publik apo ndërmarrjeje publike, apo një drejtori, apo punonjësi të një organizate publike ndërkombëtare në lidhje me një proces prokurimi ose në nënshkrimin e një kontrate në lidhje me ato elemente të projektit të përshkruara në përshkrimin teknik; ose

b) çdo veprim që ndikon në mënyrë të padrejtë ose synon të ndikojë në mënyrë të padrejtë në procesin e prokurimit apo zbatimit të projektit në dëm të Huamarrësit, duke përfshirë lidhjen ndërmjet tenderuesve.

Për këtë qëllim, dija e një ministri të Huamarrësit, çdo sekretari shteti i Huamarrësit, çdo Zëvendësministri i Huamarrësit, dhe këshilltar i ministrit të Huamarrësit, menaxherit dhe çdo anëtar i personelit të zbatuesit do të konsiderohet dijeni e Huamarrësit. Huamarrësi merr masa që zbatuesit të informojë Bankën nëse vjen në dijeni të një fakti apo informacioni që tregon kryerjen e një veprimi të tillë.

ii) Huamarrësi fillon, ruan dhe respekton procedurat e brendshme dhe kontrollon respektimin e ligjeve të brendshme dhe praktikave më të mira për qëllimet e sigurimit që të mos ketë asnjë transaksion të lidhur nga, ose në përfitim të një individi apo instituti të caktuar në listat e përditësuara të personave të sanksionuar të shpallur nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara dhe komitetet e tij në pajtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit 1267 (1999), 1373 (2001) (www.un.org/terrorism) dhe/ose nga Këshilli i BE-së në pajtim me pozicionet e përbashkëta 2001/931/CSFP dhe 2002/402/CSFP dhe rezolutat e tyre përkatëse ose pasuese dhe/ose aktet zbatuese në lidhje me financimin e çështjeve të terrorizmit.

Neni 7 Garancia

Detyrimet e parashikuara në nenin 7 mbeten në fuqi nga data e kësaj kontrate dhe për aq kohë sa një shumë ka mbetur e pashlyer sipas kësaj kontrate ose kredia është në fuqi.

7.01 Renditja *pari passu*

Huamarrësi siguron që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj kontrate renditen dhe do të renditen jo më pak se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhme të pasiguruara në bazë të instrumenteve të borxhit të jashtëm përveç se për detyrimet që preferohen në mënyrë të detyruar duke u zbatuar për shoqëritë në përgjithësi.

Veçanërisht, nëse Banka bën një kërkesë në pajtim me nenin 10.01 ose nëse një ngjarje ose një ngjarje e mundshme e qenies në vonesë në bazë të një instrumenti të jashtëm borxhi të pasiguar dhe të pavarur të Huamarrësit ose të një prej agjencive të tij ose instrumentaliteteve ka ngjarë dhe vazhdon, Huamarrësi nuk bën (autorizon) asnjë pagesë në lidhje me një instrument borxhi të jashtëm (qoftë e planifikuar rregullisht apo ndryshe) pa paguar njëkohësisht, ose hequr mënjanë në një llogari të destinuar për pagesën në datën pasuese të pagesës të një shume të barabartë, të njëjtin raport të borxhit të papaguar në bazë të kësaj kontrate, si dhe raportin e pagesës në bazë të këtij instrumenti të borxhit të jashtëm ndaj borxhit të plotë që është i papaguar në bazë të atij instrumenti. Për këtë qëllim, çdo pagesë e një instrumenti borxhi të jashtëm që bëhet nga shumatat e emetimit të një instrumenti tjetër, tek i cili është abonuar i njëjti person që ka pretendimin sipas Instrumentit të borxhit të jashtëm, nuk merret parasysh.

Në këtë kontratë, “instrumenti i borxhit të jashtëm” do të thotë: a) një instrument, duke përfshirë një marrje ose pasqyrë llogarie, që provon ose përbën një detyrim për të shlyer një hua, depozitë, parapagim apo shtyrje të ngjashme të kredisë (duke përfshirë pa kufizim çdo shtyrje të kredisë në bazë të një marrëveshjeje rifinancimi dhe riplanifikimi); b) një detyrim të provuar nga një obligacion, dëftesë borxhi apo provë e ngjashme me shkrim për qenien në borxh; ose c) një garanci të një detyrimi që rrjedh nga një instrument borxhi të jashtëm ose një tjetër, me kusht që në çdo rast një detyrim i tillë të rregullohet nga një sistem ligjor i ndryshëm nga ligji i Huamarrësit.

7.02 Garancia

Nëse Huamarrësi i jep një pale të tretë një garanci për përmbushjen e një instrumenti të jashtëm borxhi ose një preferencë apo prioritet në lidhje me këtë, Huamarrësi, nëse i kërkohet nga Banka, i jep Bankës garancinë e barasvlershme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate për t'i dhënë Bankës preferencën ose prioritetin e barasvlershëm.

7.03 Klauzolat e përfshirjes

Nëse Huamarrësi përfundon me një kreditor tjetër afatgjatë ose afatmesëm një marrëveshje financimi që përfshin një dispozitë mbi mospasjen e një tatimi apo një detyrim apo dispozitë në lidhje me renditjen *pari passu* apo qenien e dyfishtë në vonesë, që është më rigorozë se një dispozitë ekuivalente e kësaj kontrate, Huamarrësi e informon për këtë Bankën dhe, me kërkesë të Bankës, nënshkruan një marrëveshje për të ndryshuar kontratën për të parashikuar një dispozitë ekuivalente në favor të Bankës.

Neni 8 Informacioni dhe vizitat

8.01 Informacioni në lidhje me projektin

Huamarrësi siguron që zbatuesi:

i) t'i japë Bankës:

a) informacionin në formë dhe përmbajtje, dhe gjithmonë, të përcaktuar në grafikun A.2 ose ndryshe të rënë dakord herë pas here nga palët në këtë kontratë; dhe

b) çdo informacion ose dokumente të tjera në lidhje me financimin, prokurimin, zbatimin, operimin dhe ndikimin në mjedis ose për projektin që Banka mund të kërkojë të mënyrë të arsyeshme brenda një kohe të arsyeshme;

Me kusht gjithmonë që nëse ky informacion ose dokument nuk i jepet Bankës në kohë, dhe Huamarrësi nuk e korrigjon këtë mosveprim brenda një kohe të arsyeshme të caktuar nga Banka me shkrim, Banka mund të korrigjojë mangësinë, në masën që është e mundur, duke angazhuar personelin ose konsulentët e saj ose një palë të tretë, me shpenzimet e Huamarrësit dhe Huamarrësi u jep këtyre personave të gjithë asistencën e nevojshme për këtë qëllim;

ii) t'i paraqesë për aprovim Bankës pa vonesë çdo ndryshim material në projekt, duke përfshirë, ndër të tjera, në lidhje me çmimin, projektin, planet, orarin ose programin e shpenzimeve apo planin e financimit për projektin, në lidhje me deklaratimet e bëra Bankës para nënshkrimit të kësaj kontrate;

iii) (a) mban, në një vendndodhje të vetme, për inspektim gjatë 6 (gjashtë) vjetëve nga lidhja e çdo kontrate të financuar me mjetet e huas, termat e plotë të vetë kontratës, si dhe të gjitha dokumentet materiale që i përkasin procesit të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës dhe (b) prokuron që Banka mund të inspektojë dokumentet kontraktuale që kontraktori është i detyruar të respektojë sipas kontratës së furnizimit;

iv) informon menjëherë Bankën:

a) për çdo veprim ose protestë të filluar apo kundërshtim të ngritur nga një palë e tretë apo ankesë të mirëfilltë të marrë nga Huamarrësi ose ndonjë gjykim material që ka filluar ose mund të fillojë ndaj tij në lidhje me çështjet mjedisore apo të tjera që ndikojnë mbi projektin; dhe

b) për çdo fakt apo ngjarje të njohur nga Huamarrësi, që mund të cenojë në mënyrë thelbësore ose të ndikojë mbi kushtet e nënshkrimit apo operimit të projektit;

v) i jep Bankës dokumentet e përmendura në nenin 4.03A(4) në datën e tyre përkatëse në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

8.02 Informacioni në lidhje me Huamarrësin

Huamarrësi:

(i) informon Bankën menjëherë:

a) për çdo fakt që detyron atë të parapaguajë një borxh financiar ose një financim të BE-së;

b) për çdo ngjarje ose vendim që përbën ose mund të rezultojë në ngjarje të përshkruara në nenin 4.03;

c) për çdo synim nga ana e tij për të dhënë ndonjë garanci për ndonjë prej sendeve pasurore në favor të një pale të tretë ose për të hyrë në një marrëveshje të tipit të përshkruar në nenin 7;

d) për çdo synim nga ana e tij për të hequr dorë nga pronësia e një përbërësi material të projektit;

e) për një fakt ose ngjarje që është e arsyeshme dhe e mundshme për të penguar një përmbushje thelbësore të një detyrimi të Huamarrësit sipas kësaj kontrate;

f) për një ngjarje të renditur në nenin 10.01 që ka ndodhur ose mund të ndodhë apo pritët të ndodhë; ose

g) për një gjykim, arbitrazh ose procedim administrativ apo hetim që është faktik, i mundshëm apo që ka filluar dhe që nëse vendoset negativisht rezulton në një ndryshim material negativ.

8.03 Vizitat nga Banka

Huamarrësi u lejon personave të caktuar nga Banka, si dhe personave të caktuar nga institucionet ose organet e tjera të Komunitetit Europian, nëse kjo kërkohet nga dispozitat detyruese të së drejtës së Komunitetit Europian, të vizitojnë vendet, instalimet dhe punët që përbëjnë projektin dhe të kryejnë ato kontrole që ata duan dhe u japin apo sigurojnë që ata të marrin të gjithë asistencën e nevojshme për këtë qëllim.

Huamarrësi pranon që Banka mund të jetë e detyruar të deklarojë këtë informacion në lidhje me Huamarrësin dhe projektin çdo institucioni apo organi kompetent të Bashkimit Europian, në pajtim me dispozitat detyruese të së drejtës së Komunitetit Europian.

Një rishikim i prioriteteve në terren të depozitimeve do të kryhet nga Banka me bazë vjetore.

8.04 Hetimet dhe informacioni

Huamarrësi merr përsipër:

i) të ndërmarrë çdo veprim që Banka e kërkon në mënyrë të arsyeshme për të hetuar dhe/ose ndërprerë çdo veprim që konsiderohet ose dyshohet të jetë i natyrës së përshtatur në nenin 6.09;

ii) të informojë Bankën për masat e marra për të kërkuar zhdëmtime nga personat përgjegjës për çdo humbje që rrjedh nga një veprim i tillë; dhe

iii) të lehtësojë çdo hetim që Banka mund të bëjë në lidhje me një veprim të tillë.

Neni 9

Detyrimet dhe shpenzimet

9.01 Tatimet, detyrimet dhe tarifatat

Huamarrësi paguan të gjitha taksat, detyrimet, tarifatat dhe pagesat e tjera të çdo natyre, duke përfshirë tarifën e pullës dhe tarifatat e regjistrimit që rrjedhin nga nënshkrimi ose zbatimi i kësaj kontrate ose çdo dokumenti përkatës në krijimin, perfeksionimin, regjistrimin ose ekzekutimin e një garancie të huas në masën e zbatueshme.

Huamarrësi paguan të gjithë principalin, interesin, zhdëmtimin dhe shumatat e tjera të kërkueshme sipas kësaj kontrate bruto pa zbritje të ndonjë detyrimi kombëtar apo lokal; me kusht që, nëse Huamarrësi është i detyruar të bëjë këto zbritje, ai do të përshtatë pagesën për Bankën në mënyrë që bas zbritjes, shumata neto e marrë nga Banka të jetë e barabartë me shumën e kërkueshme.

9.02 Detyrime të tjera

Huamarrësi mbulon të gjitha detyrimet dhe shpenzimet, duke përfshirë detyrimet profesionale, bankare ose të këmbimit që shkaktohen në lidhje me përgatitjen, nënshkrimin, zbatimin dhe prishjen e kësaj kontrate ose të çdo dokumenti përkatës, çdo ndryshimi, zbatimi apo heqje dorë në lidhje me këtë kontratë apo dokument përkatës, dhe në ndryshimin, krijimin, menaxhimin dhe realizimin e çdo garancie të huas, si dhe të shpenzimeve të Bankës sipas nenit 8.04.

Banka jep mbështetjen dokumentare për çdo detyrim apo shpenzim të tillë 14 (katërmëdhjetë) ditë para se kërkesa për pagesë të bëhet e kërkueshme.

Neni 10

Ngjarjet e qenies në vonesë

10.01 E drejta për të kërkuar shlyerjen

Huamarrësi shlyen të gjithë ose një pjesë të huas menjëherë, së bashku me interesin e mbledhur dhe shumatat e tjera të kërkueshme, me kërkesën me shkrim të bërë nga Banka, në pajtim me dispozitat e mëposhtme.

10.01A Kërkesa e menjëhershme

Banka mund ta bëjë këtë kërkesë menjëherë:

i) Nëse Huamarrësi nuk paguan në datën e kërkueshme një pjesë të huas, të paguajë interesin e saj ose të bëjë një pagesë tjetër për bankën sipas parashikimit në këtë kontratë;

ii) Nëse një informacion apo dokument i dhënë Bankës nga ose në emër të Huamarrësit ose një përfaqësim apo deklaram i bërë ose konsiderohet të jetë bërë nga Huamarrësi në lidhje me negocimin e kësaj kontrate apo në këtë kontratë është apo duket se është e pasaktë ose e gabuar në një aspekt material;

iii) Nëse, pas një qenieje në vonesë në lidhje me to, Huamarrësit i kërkohet ose është në gjendjen që mund t'i kërkohet ose pas skadimit të një periudhe kontraktuale të zbatueshme pa pagesa, i kërkohet ose është në gjendjen që t'i kërkohet të parapaguajë, shlyejë, mbyllë apo përfundojë para maturimit një hua tjetër ose detyrim që rrjedh nga një veprim financiar ose detyrim për një hua tjetër apo detyrim që rrjedh nga një veprim financiar që anulohet ose pezullohet;

iv) Nëse Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet që bëhen të kërkueshme ose pezullon borxhet e tij, ose pa njoftuar paraprakisht me shkrim Bankën, kërkon të bëjë një marrëveshje me kreditorët e tij;

v) Nëse Huamarrësi është në vonesë në lidhje me përmbushjen e një detyrimi në lidhje me një hua ose instrument tjetër financiar të dhënë nga Banka ose të mbajtur nga Banka;

vi) Nëse Huamarrësi është në vonesë në lidhje me përmbushjen e një detyrimi mbi një financim tjetër të dhënë nga Banka nga burimet e Bankës ose të Bashkimit Europian;

vii) Nëse, pas qenies në vonesë të Huamarrësit në përmbushjen e një detyrimi në lidhje me një hua të përmendur në paragrafin hyrës (2) ose një grandit të dhënë atij nga Bashkimi Europian, e drejta e Huamarrësit për të tërhequr shumat e huas ose të një grandit do të jetë anuluar ose pushuar plotësisht ose pjesërisht, ose nëse ajo hua apo grand është bërë i shlyeshëm në pajtim me termat e tij;

viii) Nëse ndodh një ndryshim material negativ; ose

ix) Nëse është ose bëhet e paligjshme për Huamarrësin të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij në bazë të kësaj kontrate ose kjo kontratë nuk është në fuqi në pajtim me kushtet e saj ose konsiderohet nga Huamarrësi të mos jetë në fuqi në pajtim me termat e saj.

10.01B Kërkesa pas njoftimit për korrigjim

Banka mund të kërkojë gjithashtu:

i) Nëse Huamarrësi nuk përmbush plotësisht një detyrim sipas kësaj kontrate që nuk është një detyrim i përmendur në nenin 10.01A; ose

ii) Nëse një fakt i përmendur në paragrafët hyrës ndryshon materialisht dhe nuk rivendoset materialisht dhe nëse ndryshimi ose cenon interesat e Bankës si huadhënës për Huamarrësin, ose ndikon në mënyrë negative në zbatimin ose operimin e projektit.

Përveç kur mosrespektimi ose rrethanat që shkaktojnë këtë mosrespektim mund të korrigjohen dhe korrigjohen brenda një periudhe të arsyeshme kohe të përcaktuar në njoftimin e dhënë nga Banka Huamarrësit.

10.02 Të drejta të tjera ligjore

Neni 10.01 nuk kufizon asnjë të drejtë tjetër të Bankës sipas ligjit për të kërkuar shlyerjen e huas.

10.03 Zhdëmtimi

10.03A Transhet me normë fikse

Në rastin e një kërkesë sipas nenit 10.01 në lidhje me transhin e normës fikse, Huamarrësi i paguan Bankës shumën e kërkuar së bashku me shumën e llogaritur në pajtim me nenin 4.02B për çdo shumë që është bërë e kërkueshme dhe e pagueshme. Kjo shumë mblidhet nga data e kërkueshme për pagesë të përcaktuar në njoftimin e Bankës për kërkesën dhe llogaritet mbi bazën që parapagimi realizohet në datën e përcaktuar në këtë mënyrë.

10.03B Transhet me normë të ndryshueshme

Në rastin e një kërkesë sipas nenit 10.01 në lidhje me transhin e normës së ndryshueshme, Huamarrësi i paguan Bankës shumën e kërkuar së bashku me shumën e barabartë me vlerën e

tashme të 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë) në vit të llogaritur dhe që mbledhet në shumën e kërkueshme që parapaguhet në të njëjtën mënyrë si çdo të llogaritej interesi dhe do të ishte mbledhur, nëse shuma do të kishte mbetur e pashlyer sipas grafikut fillestar të amortizimit të transhit, deri në datën e maturimit.

Vlera llogaritet me një normë skontoje të barabartë me normën e rivendosjes që aplikohet për çdo datë përkatëse të pagesës.

10.03C Të përgjithshme

Shumat e kërkueshme nga Huamarrësi në pajtim me këtë nen 10.03 paguhen në datën e parapagesës të përcaktuar në kërkesën e Bankës.

10.04 Mosheqja dorë

Asnjë moskryerje, vonesë, ushtrim i vetëm apo i pjeshëm nga Banka në ushtrimin e të drejtave ose mjeteve të saj sipas kësaj kontrate nuk interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë apo mjet. Të drejtat dhe mjetet e parashikuara në këtë kontratë janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese për asnjë të drejtë apo mjet të parashikuar me ligj.

10.05 Zbatimi i shumave të marra

Shumat e marra nga Banka pas kërkesës sipas nenit 10.01 zbatohen së pari në pagesën e shpenzimeve, interesit dhe zhdëmtimeve dhe së dyti në uljen e kësteve të pashlyera në rend të zhdrejtë të maturimit. Banka mund të aplikojë shumat e marra ndërmjet transheve sipas çmimit të saj.

Neni 11

Ligji dhe juridiksioni

11.01 Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.02 Juridiksioni

Palët i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Europiane.

Palët në këtë kontratë heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e këtyre gjykatave. Një vendim i gjykatave i dhënë në pajtim me këtë nen është përfundimtar dhe detyrues për çdo palë dhe pa kufizim apo rezervë.

11.03 Provat për shumat e kërkueshme

Në çdo padi që rrjedh nga kjo kontratë, certifikata e Bankës në lidhje me shumat apo normat e kërkueshme nga Banka sipas kësaj kontrate, në mungesë të gabimit të dukshëm, janë prova *prima facie* të kësaj shume apo norme.

Neni 12

Dispozita të fundit

12.01 Njoftimet për palët

Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna sipas kësaj kontrate drejtuar palës tjetër në këtë kontratë bëhen në adresën ose numrin e faksit të përcaktuar më poshtë ose në një adresë tjetër ose numër faksi që një palë ka njoftuar më parë tjetrën me shkrim:

Për Bankën

100 boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

Nr. faksi: +352 4379 6 7487

Për Huamarrësin

Ministri i Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.1

Tirana, Albania

Numër faksi: </>

Cc Zbatuesi

Rr. “Sami Frashëri”, Nr.10

Tirana, Albania

Numër faksi: 00355 4 234 885

Përveç kur Huamarrësi specifikon ndryshe me shkrim Bankën, Ministri i Financave është përgjegjës për kontaktet me Bankën për qëllimet e nenit 6.09.

12.02 Forma e njoftimit

Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë në bazë të kësaj kontrate duhet të jetë me shkrim.

Njoftimet ose komunikimet e tjera, për të cilat caktohen periudha të prera në këtë kontratë ose që periudhat fikse janë detyruese për marrësin, mund të bëhen dorazi, me letër rekomande ose faks. Data e dorëzimit, regjistrimit ose, sipas rastit, data e caktuar në marrjen e transmetimit është përfundimtare për përcaktimin e një afati.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera mund të dorëzohen dorazi, me letër rekomande ose faks, ose në masën që është rënë dakord nga palët me marrëveshje me shkrim, e-mail ose komunikim tjetër elektronik.

Pa cenuar vlefshmërinë e një njoftimi të dhënë me faks sipas paragrafëve të mësipërm, një kopje e çdo njoftimi të dhënë me faks i dërgohet gjithashtu me letër palës tjetër jo më vonë se në ditën pasuese të punës.

Njoftimet e bëra nga Huamarrësi në pajtim me një dispozitë të kësaj kontrate, nëse kërkohet nga Banka, i dorëzohet bankës së bashku me provat e pranueshme të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar këtë njoftim në emër të Huamarrësit dhe ekzemplarët e vërtetuar të firmave të këtij ose këtyre personave.

12.03 Ndryshimet e palëve

Huamarrësi nuk mund të cedojë apo transferojë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj kontrate pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

Banka mund të cedojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave dhe përfitimeve ose transferojë (nëpërmjet rinovimit ose nën pjesëmarrje apo ndryshe) të gjitha ose një pjesë të të drejtave, përfitimeve dhe detyrimeve sipas kësaj kontrate.

12.04 Paragrafët hyrës, grafikët dhe anekset

Komentet hyrëse dhe grafikët dhe anekset e mëposhtëm përbëjnë pjesë të kësaj kontrate:

Grafiku A	Përshkrimi teknik dhe raportimi
Grafiku B	Përkufizimi i EURIBOR-it
Grafiku C	C.1 Formulari i kërkesës së livrimit (1.02B) C.2 Formulari i certifikatës nga Huamarrësi (neni 1.04C)

Aneksi I: Kompetencat për nënshkrim të Huamarrësit

Në dëshmi të kësaj, palët kanë realizuar nënshkrimin e kësaj kontrate në 4 kopje origjinale në gjuhën angleze dhe për rrjedhojë kanë realizuar ----- çdo faqe të kësaj kontrate në emër të tyre.

Në __, më __ 2010

Nënshkruar për dhe në emër të
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nënshkruar për dhe në emër të
BANKËS EUROPIANE TË
INVESTIMEVE

</>

</>

</>

</>

</>

</>

GRAFIKU A

A.1. PËRSHKRIMI TEKNIK

Ky projekt do të mbulojë afërsisht 500 km rrugë sekondare dhe lokale. Ka tre komponentë kryesorë në projekt:

- Punët në lidhje me përmirësimin e seksioneve prioritare të rrjetit rrugor sekondar (rajonale). Për shkak të gjendjes së dobët të rrjetit, ndërhyrjet sipas këtij komponenti pritet të jenë rehabilitimi ose rindërtimi (duke përfshirë strukturën e urave). Propozimi provizor është që rrugët dytësore (rajonale) të rindërtoheshin me një karrexhatë me dy korsi të shtruar me gjerësi 6.0 deri 7.5 m me, përkatësisht, trotuare të shtruara nga të dyja anët ndërmjet 1.25 dhe 1.5 m (trotuaret, nëse mund të bëhet lirisht, mund të ulen në 0.5 m nëse e drejta ekzistuese e kalimit pengon gjerësinë e trotuarit). Rrugët do të përfshijnë anë prej 0.5 m në të dyja anët e strukturës së asfaltit. Në zonat urbane, trotuaret e shtruara (min 1.0 m) do të zëvendësoheshin me trotuaret e para nëse nuk mund të bëhen të dy. Nëse është e nevojshme, do të përfshihet edhe infrastruktura e sigurisë së rrugës.

- Punët në lidhje me përmirësimin e seksioneve prioritare të rrjetit të rrugëve lokale (komunale). Rrugët (duke përfshirë strukturat e urave) do të rindërtoheshin me një karrexhatë me një korsi prej 3.5m dhe 1.0m trotuar të shtruar në secilën anë për rrugët e tipit L1, 3.25m dhe 1.0m trotuare të shtruara në secilën anë për rrugët e tipit L2 dhe 3.0m dhe 0.5m trotuare të shtruara për secilën anë për rrugët e tipit L3. Rrugët do të përfshijnë më tej pjesë prej 0.5m në secilën anë të strukturës së asfaltit. Në zonat urbane, trotuaret e shtruara (min 1.0m) do të zëvendësoheshin me trotuaret e para nëse nuk mund të bëhen të dy. Nëse është e nevojshme, do të përfshihet edhe infrastruktura e sigurisë së rrugës.

Zbatimi dhe komponenti i mbështetjes institucionale do të financojë deri në shumën 2 000 000 euro (dy milionë euro) dhënien e mbështetjes teknike për të asistuar ADF-në në zbatimin e projektit, mbështetjen institucionale (si menaxhimi i aseteve, çështja e sigurisë së rrugëve), përpilimi i kërkesave të projektit të detajuar për komponentët e rrugës sipas projektit dhe mbikëqyrjes së rrugëve.

Projektet e rrugëve do të kryhen në pajtim me udhëzimet për projektet ndërkombëtare si praktika më të mira, që janë në pajtim me projektin e fundit të Manualit Shqiptar për Projektin e Rrugëve (ARDM), që tashmë është në fazat e fundit të përgatitjes me mbështetjen e Bashkimit Europian. Konfirmimi i standardeve të ndërseksioneve të rrugëve duhet të përfshihen si pjesë e punës së përgjithshme për projektimin e rrugëve në këtë projekt.

Punët do të përbëhen normalisht nga rindërtimi i trotuareve (duke përfshirë nënshtresën nëse është e nevojshme), sigurimi ose rehabilitimi i kullimeve, sinjalistika rrugore, masat e sigurisë së rrugëve, muret mbrojtëse dhe rehabilitimi ose rindërtimi i urave.

Identifikimi dhe procesi i zgjedhjes për seksionet e rrugëve që duhet të përfshihen në projektet bazohen në analizën dhe prioritetet e multikritereve.

Lista e projekteve që duhet të financohet nga ky projekt do t'i nënshtrohet pëlqimit të Bankës para livrimit.

Kalendari

Projekti pritet të fillojë në tremujorin e dytë të vitit 2010 me një përfundim të pritshëm të ndërtimit në vitin 2015.

A.2 INFORMACION MBI PROJEKTIN QË I DËRGOHET BANKËS DHE MËNYRA E TRANSMETIMIT

1. Dërgimi i informacionit: Destinacioni dhe personi përgjegjës
Informacioni i mëposhtëm i është dërguar Bankës në përgjegjësi të:

Shoqëria/zbatuesi	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Personi i kontaktit	Benet BECI
Titulli	Drejtori ekzekutiv
Funksioni/departamenti	
Adresa	Rr. "Sami Frashëri", nr.10, Tirana, Albania
Tel.	Tel./ Fax: 00355 4 234 885
Faks	
Email	E-mail: adf@albaniandf.org

Personi(at) e sipërpërmendur është(janë) kontaktet përgjegjëse për momentin. Huamarrësi informon EIB-në menjëherë në lidhje me ndonjë ndryshim.

2. Informacioni mbi subjektet specifike

Huamarrësi i jep Bankës nëpërmjet zbatuesit informacionin e mëposhtëm jo më vonë se afati i fundit i treguar më poshtë:

Dokumenti/informacioni	Afati
Lista e projektit të seksionit të rrugëve në projekt (duke përfshirë normat e parashikuara të kthimit)	Para përfshirjes në objektin e projektit dhe/ose para kërkesës së livrimit
Përditësimi i listës së projektit	Me ndodhjen e ndryshimeve
Dokumentet e tenderit, raportet e vlerësimit të tenderit, kontratat	Siç kërkohet

Banka mund të kërkojë informacion shtesë për të përmbushur ndonjë kërkesë të kontribuesve si palë e tretë në projekt dhe që administrohen nga Banka

3. Informacioni mbi zbatimin e projektit

Huamarrësi i jep Bankës nëpërmjet zbatuesit informacionin e mëposhtëm mbi progresin e projektit gjatë zbatimit jo më vonë se afati që tregohet më poshtë.

Dokumenti/informacioni	Afati	Frekuenca e raportimit
<p>Raporti i progresit të projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një përditësim i shkurtër për përshkrimin teknik, shpjegim të arsyeve për ndryshimet kryesore kundrejt objektit fillestar; - Përditësim mbi datën e përfundimit të çdo komponenti kryesor të projektit, duke shpjeguar shkaqet për çdo vonesë të mundshme; - Përditësim mbi koston e projektit, duke shpjeguar shkaqet për çdo rritje të mundshme të koston kundrejt koston fillestare të buxhetit; - Një përshkrim i një çështjeje madhore me ndikim mjedisor; - Përditësim mbi procedurat e prokurimit (jashtë BE-së); - Përditësim mbi kërkesën e projektit ose përdorimin dhe komentet; - Një çështje e rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo risk i konsiderueshëm që mund të ndikojë në operimin e projektit; - Çdo padi në lidhje me projektin që mund të jetë në vazhdim. 		Me bazë tremujore

4. Informacioni mbi përfundimin e punëve dhe viti i parë i operimit

Huamarrësi i jep Bankës nëpërmjet zbatuesit informacionin e mëposhtëm mbi përfundimin e projektit dhe operimin fillestar jo më vonë se afati i fundit i treguar më poshtë.

Dokumenti/informacioni	Data e dorëzimit në Bankë
<p>Raport i përfundimit të projektit, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një përditësim të shkurtër për përshkrimin teknik, shpjegim të arsyeve për ndryshimet kryesore; - Data e përfundimit të çdo komponenti kryesor të projektit, duke shpjeguar shkaqet për çdo vonesë të mundshme; - Kostoja përfundimtare e projektit, duke shpjeguar shkaqet për ndonjë rritje të mundshme të koston kundrejt koston fillestare të buxhetit; - Numri i punëve të reja të krijuara nga projekti: punët gjatë zbatimit dhe punët e përhershme të reja të krijuara; - Një përshkrim i një çështjeje madhore me ndikim në ambient; - Përditësim mbi procedurat e prokurimit (jashtë BE-së); - Përditësim mbi kërkesën e projektit ose përdorimin dhe komentet; - Një çështje e rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo risk i konsiderueshëm që mund të ndikojë në operimin e projektit; - Çdo padi në lidhje me projektin që mund të jetë në vazhdim. 	15 muaj pas përfundimit fizik të projektit
...	

Gjuha e raporteve	Anglisht
--------------------------	-----------------

GRAFIKU B PËRKUFIZIM I EURIBOR-IT

A. EURIBOR është:

i) Në lidhje me periudhën përkatëse prej më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në euro me një afat prej një muaj;

ii) Në lidhje me një periudhë përkatëse prej një muaji ose më shumë muaj të plotë, norma e interesit për depozitat në euro për një afat për numrin përkatës të muajve të plotë; dhe

iii) Në lidhje me periudhën përkatëse të më shumë se një muaji (por jo muaj të plotë), norma që rrjedh nga interpolimi i referencës së dy normave për depozitat në euro, një prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë për muaj të plotë më e shkurtër se tjetra për një periudhë të muajve të plotë më të gjatë se gjatësia e periudhës përkatëse

(periudha për të cilën merret norma ose nga e cila normat interpelohen është “periudha përfaqësuese”).

Që publikohet në 11h00, ora e Brukselit ose në një kohë më të mëvonshme të pranueshme nga Banka në ditën e (data e rivendosjes) që bie 2 (dy) ditë përkatëse pune para ditës së parë të periudhës përkatëse, në faqen e Reuter-it EURIBOR 01 ose faqen pasuese, ose nëse nuk ekzistojnë, me një mjet tjetër publikimi të zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Nëse një normë e tillë nuk publikohet, Banka u kërkon zyrave qendrore të zonës së euros të katër bankave madhore, të zgjedhura nga Banka, të caktojnë normën në të cilën depozitat në euro ofrohen në një shumë të krahasueshme nga secila prej tyre në afërsisht 11h00, ora e Brukselit, në datën e rivendosjes për bankat kryesore në tregun ndërbankar të eurozonës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse jepen të paktën 2 (dy) kuotime, norma për atë datë rivendosjeje do të jetë rezultati aritmetik i kuotimeve.

Nëse jepen më pak se 2 (dy) kuotime, norma për atë datë të rivendosjes do të jetë rezultati aritmetik i normave të kuotuar nga bankat kryesore në euro-zonë, të zgjedhura nga Banka, afërsisht në orën 11h00 të Brukselit në ditën që bie 2 (dy) ditë përkatëse biznesi pas datës së rivendosjes, për huat në euro në një shumë të krahasueshme për Bankat kryesore europiane për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

B. Të përgjithshme

Për qëllimet e përkufizimeve të mësipërme:

i) Të gjitha përqindjet që rezultojnë nga llogaritjet e përmendura në këtë grafik rrumbullakosen, sipas rastit, në pikën më të afërt të njëqind mijë përqindje dhe gjysma mblidhet.

ii) Banka informon Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra nga Banka.

iii) Nëse një nga dispozitat e mësipërme nuk është në pajtim me dispozitat e miratuara nën kujdesin e EURIBOR FBE dhe EURIBOR ACI, Banka, me njoftim drejtuar Huamarrësit, mund të ndryshojë dispozitën për ta sjellë atë në pajtim me dispozitat e tjera.

GRAFIKU C
C.1 FORMULARI I KËRKESES SË LIVRIMIT (NENI 1.02B)
SHQIPËRIA – PROGRAMI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE

Datë:

Jeni të lutur të procedoni me livrimin e mëposhtëm:

Emri i huas:

PROGRAMI I RRUGËVE LOKALE DHE SEKONDARE

Data e firmës:

Numri FI i kontratës:

Monedha dhe shuma e kërkuar	
Monedha	Shuma

Data e propozuar e livrimit:

I N T E R E S I	Interesi bazë (neni 3.01)	<input style="width: 100%;" type="text"/>
	Norma (% ose <i>spread</i>) ¹	<input style="width: 100%;" type="text"/>
	Frekuenca (neni 3.01)	Vjetore <input type="checkbox"/> Gjashtëmujore <input type="checkbox"/> Tremujore <input type="checkbox"/>
	Datat e pagesës (neni 5)	<input style="width: 100%;" type="text"/>
	Interesi	<input style="width: 100%;" type="text"/>

K A P I T A L I	Frekuenca e shlyerjes	Vjetore <input type="checkbox"/> Gjashtëmujore <input type="checkbox"/> Tremujore <input type="checkbox"/>
	Metodologjia e shlyerjes (neni 4.01)	Këste të barabarta <input type="checkbox"/> Tarifa konstante <input type="checkbox"/> Këst i vetëm <input type="checkbox"/>
	Data e parë e shlyerjes	<input style="width: 100%;" type="text"/>
	Data e maturimit	<input style="width: 100%;" type="text"/>

Rezervuar për EIB	(monedha e kontratës)
Shuma e plotë e kredisë:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Livruar deri më sot:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Balanca për livrimet:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Livrimi i tashëm:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Balanca pas livrimit:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Afati i livrimit:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Numri maksimal i livrimeve:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Madhësia minimale e transhit:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Alokimi i plotë deri tani:	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Kushtet paraprake:	Po / Jo

Llogaria e Huamarrësit për t'u kredituar:

Acc. N°:

(Jeni të lutur të jepni formatin e IBAN-it në rastin e lëvrimeve në euro, ose formatin përkatës për monedhën përkatëse.)

Emri i Bankës, adresa:

Jeni të lutur të transmetoni informacionin përkatës tek:

Emri(at) e autorizuar të Huamarrësit dhe firma(t)

C.2 FORMULARI I CERTIFIKATËS SË HUAMARRËSIT (NENI 1.04C)

Drejtuar: Bankës Europiane për Investimet

Nga:

[Datë]

Lënda: Kontratë financimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Investime të datës ...(kontrata e financimit) Nr. Fl Nr. Serapis 2007-0519

Të nderuar zotërinj,

Termet e përkufizuar në kontratën e financimit kanë kuptimet e përdorura në këtë letër.

Për qëllimet e nenit 1.04 të kontratës së financimit, vërtetojmë sa më poshtë:

- i) Nuk krijohet garanci e tipit të ndaluar nga neni 7 dhe një e tillë nuk ekziston;
- ii) Nuk ka pasur ndryshim material në asnjë aspekt të projektit në lidhje me të cilin Huamarrësi është i detyruar të raportojë sipas nenit 8.01, përveç sa është komunikuar nga Huamarrësi;
- iii) Ne kemi fonde të mjaftueshme të disponueshme për të siguruar përfundimin në kohë dhe zbatimin e projektit në pajtim me grafikun A;
- iv) Asnjë ngjarje ose rrethanë që përbën ose do të përbente me kalimin e kohës ose bërjen e njoftimit sipas kontratës së financimit një ngjarje të qenies në vonesë sipas nenit 10.01 nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon e pakorrigjuar apo pa hequr dorë;
- v) Asnjë gjykim, arbitrazh, procedurë administrative apo rregullatore ose hetim është faktik apo sipas dijenisë tonë mund të fillojë apo është në vazhdim në ndonjë gjykatë, arbitrazh ose agjenci që ka rezultuar ose që nëse vendoset negativisht mund të ketë si rezultat një ndryshim material negativ, dhe nuk ka kundër nesh apo filialeve tona ndonjë gjykim apo vendim negativ;
- vi) Përfaqësimet dhe garancitë e bëra ose të përsëritura nga Huamarrësi sipas nenit 6.08 janë të vërteta në të gjitha aspektet materiale;
- vii) Asnjë ngjarje nga ato të përmendura në nenin 4.03 nuk ka ndodhur; dhe
- viii) Asnjë ndryshim material negativ nuk ka ndodhur.

Me respekt,

Për dhe në emër të </>

Datë:

LIGJ
Nr.10 312, datë 16.9.2010

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE (FAZA II)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (OFID) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe lokale (faza II)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6687, datë 27.9.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

HUA Nr. _____ P

PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE
(FAZA II)
MARRËVESHJE HUAJE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT
TË OPEC-ut PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
DATË _____, 2010

Marrëveshje e datës _____, 2010, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe OFID-it.

Duke marrë parasysht se Huamarrësi ka kërkuar një hua nga OFID-i për financimin e pjeshëm të projektit të përshkruar në skedulën 1;

dhe duke marrë parasysht se OFID-i ka miratuar një hua për Huamarrësin në një shumë prej dhjetë milionë dollarësh (\$ 10 000 000), sipas termave dhe kushteve të përcaktuara më poshtë; rrjedhimisht, palët e kësaj Marrëveshjeje huaje (Marrëveshja) bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç termave të përcaktuar në hyrje, termat dhe shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme ose, kur ata përsëritin termat dhe shprehjet në kushtet e përgjithshme, kuptimet specifike të mëposhtme:

- a) “Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit;
- b) “Data e mbylljes” është 30 qershor 2014;
- c) “Dollar dhe shenja \$” nënkupton dhe i referohet monedhës zyrtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- d) “Data e fillimit të shpenzimeve të pranueshme” është 16 mars 2010;
- e) “Agjencia zbatuese” është Fondi Shqiptar i Zhvillimit i Huamarrësit;
- f) “Kushtet e përgjithshme” janë kushtet e përgjithshme të OFID-it të zbatueshme në marrëveshjet e huas në sektorin publik, dhjetor 2007; dhe
- g) “Periudhë pa pagesë principale” është periudha që fillon nga [data e Marrëveshjes] dhe mbaron pesë (5) vjet nga ajo datë.

Neni 2 Huaja

2.01 OFID-i bie dakord t’i japë hua Huamarrësit dhe Huamarrësi bie dakord të marrë hua nga OFID-i huan në një shumë prej dhjetë milionë dollarësh (\$ 10,000,000) në termat dhe kushtet e rëna dakord në këtë Marrëveshje.

2.02 Huamarrësi paguan interes në një masë prej tre dhe një të dytat e një përqindëshit (3.5%) në vit mbi shumën principale të huas së tërhequr dhe të patërhequr.

2.03 Huamarrësi paguan një pagesë shërbimi në masën një për qind (1%) në vit mbi shumën principale të huas së tërhequr dhe të patërhequr.

2.04 Interesi dhe pagesat e shërbimit paguhen çdo gjashtëmuajor më 15 qershor dhe 15 dhjetor të çdo viti në llogarinë e OFID-it.

2.05 Menjëherë pas përfundimit të periudhës pa pagesë principale, Huamarrësi do të shlyejë principalin e huas në dollarë apo në çdo monedhë tjetër lehtësisht të konvertueshme, të pranueshme nga autoriteti drejtues i OFID-it, në një shumë të barasvlefshme me shumën në dollarë të pagueshme, të caktuar sipas kursit të këmbimit të tregut në vendin dhe kohën e shlyerjes. Shlyerja do të kryhet në tridhjetë (30) këste gjashtëmuajore në shumat dhe në datat që janë përcaktuar në skedulën 3 (amortizimi).

Neni 3 Hyrja në fuqi

3.01 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt në përputhje me seksionin 3.02 pas marrjes nga OFID-i të:

- a) të të dhënave të mjaftueshme se zbatimi dhe dorëzimi i kësaj marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar dhe ratifikuar sipas kërkesave kushtetuese të Huamarrësit;

- b) një vërtetimi të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë apo përfaqësuesi ligjor i përgjithshëm apo çdo autoritet ligjor tjetër kompetent i Huamarrësit që vërteton se kjo Marrëveshje është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të kërkuar për Huamarrësin në përputhje me termat e saj.

3.02 Pasi kushtet e specifikuar në seksionin 3.01 të jenë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt në datën e hyrjes në fuqi.

3.03 Nëse kjo Marrëveshje nuk bëhet efektive brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së Marrëveshjes, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë, përveç nëse autoriteti drejtues i OFID-it, pasi të marrë parasysh arsyet për vonesë, do të caktojë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni.

Neni 4
Adresat

4.01 Adresat e palëve janë siç specifikohen më poshtë:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit", nr.4,
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faks: (+ + 335-4) 229200

Për OFID:

Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
Parkring 8
A-1010 Vienna
Austria
Faks: (+ + 43-1) 513 92 38

HUA Nr. ____ P

Në dëshmi të kësaj, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet dhe dërgohet në Vjenë në dy kopje në gjuhën angleze, secili i konsideruar një origjinal dhe të dy me të njëjtin efekt si në ditën dhe vitin e shënuar për herë të parë më sipër.

PËR HUAMARRËSIN:

Nënshkrimi: _____
Emri: _____
Titulli: _____

PËR FONDIN E OPEC-ut PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR:

Nënshkrimi: _____
Emri: Suleiman J. Al-Herbish
Titulli: Drejtor i Përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE (FAZA II)

SKEDULI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti është rehabilitimi dhe rindërtimi i rreth 45 km pjesë rrugësh dytësore dhe lokale në zona të rajoneve perëndimore të Durrësit dhe Lezhës, dhe zonave të tjera sipas përparësisë dhe përzgjedhjes nga programi i bazës së të dhënave të rrugëve dytësore dhe lokale. Projekti mbështet planin e strategjisë së zhvillimit të Huamarrësit për të lidhur fshatrat lokale me rrjetin bazë rrugor, si dhe qendrat kryesore mjekësore dhe të edukimit. Objektivat e projektit do të arrihen nëpërmjet zbatimit të komponentëve të mëposhtëm:

a) Punime civile-rrugë dytësore: Ky komponent do të financojë rindërtimin dhe/ose rehabilitimin e rrugëve dytësore. Rrugët do të përmirësohen me një korsi të shtruar me asfalt. Siguria rrugore dhe infrastruktura e kullimit do të instalohen ku të jetë e nevojshme.

b) Punime civile-rrugë lokale: Ky komponent do të financojë rindërtimin dhe/ose rehabilitimin e rrugëve lokale. Rrugët do të përmirësohen me një korsi të shtruar me asfalt. Siguria rrugore dhe infrastruktura e kullimit do të instalohen ku të jetë e nevojshme.

c) Menaxhimi i projektit dhe mbështetja institucionale: Ky komponent do të financojë kostot e shërbimeve të konsulencës, trajnimeve dhe kostot operacionale të agjencisë zbatuese.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE (FAZA II)

SKEDULI 2
ALOKIMI I HUAS

1. Përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe autoritetit drejtues të OFID-it, tabela e mëposhtme përcakton komponentët që do të financohen nga të ardhurat e huas, alokimin e shumave të huas në çdo komponent dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që do të financohen në lidhje me çdo komponent:

Komponenti	Shuma e huas e caktuar (shprehur në dollarë)	Përqindja e shpenzimeve totale për t'u financuar
a) Punime civile – rrugë dytësore	6 800 000	100
b) Punime civile – rrugë lokale	3 200 000	100
c) Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projektit	-	-
Totali:		10 000 000

2. Pavarësisht nga alokimi i një shume të huas apo përqindjet e disbursimit, të përcaktuara në tabelën në paragrafin 1 më sipër, nëse autoriteti drejtues i OFID-it ka çmuar në mënyrë të arsyeshme se shuma e huas e alokuar te çdo komponent do të jetë e pamjaftueshme të financojë përqindjen e miratuar të të gjitha shpenzimeve në atë komponent, autoriteti drejtues i OFID-it, me anë të një njoftimi për Huamarrësin: (i) mund të rialokojë në një komponent të tillë, në masën e kërkuar për të përmbushur mungesën e llogaritur, të ardhurat e huas, të cilat janë alokuar në një tjetër komponent dhe të cilat sipas mendimit të autoritetit drejtues të OFID-it nuk nevojiten për shpenzime të tjera; dhe (ii) nëse një rialokim i tillë nuk mund të përmbushë mungesën e llogaritur, të ulë përqindjen e disbursimit të aplikueshme për ato shpenzime, në mënyrë që tërheqje të mëtejshme në lidhje me këtë komponent mund të vazhdojnë derisa të jenë kryer të gjitha shpenzimet e mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE (FAZA II)

SKEDULI 3
AMORTIZIMI

Nr.	Data e shlyerjes	Shuma për t'u paguar (shprehur në dollarë)
1	15 qershor 2015	333 330
2	15 dhjetor 2015	333 330
3	15 qershor 2016	333 330
4	15 dhjetor 2016	333 330
5	15 qershor 2017	333 330
6	15 dhjetor 2017	333 330
7	15 qershor 2018	333 330
8	15 dhjetor 2018	333 330
9	15 qershor 2019	333 330
10	15 dhjetor 2019	333 330
11	15 qershor 2020	333 330
12	15 dhjetor 2020	333 330
13	15 qershor 2021	333 330
14	15 dhjetor 2021	333 330
15	15 qershor 2022	333 330
16	15 dhjetor 2022	333 330
17	15 qershor 2023	333 330
18	15 dhjetor 2023	333 330
19	15 qershor 2024	333 330
20	15 dhjetor 2024	333 330
21	15 qershor 2025	333 330
22	15 dhjetor 2025	333 330
23	15 qershor 2026	333 330
24	15 dhjetor 2026	333 330
25	15 qershor 2027	333 330
26	15 dhjetor 2027	333 330
27	15 qershor 2028	333 330
28	15 dhjetor 2028	333 330
29	15 qershor 2029	333 330
30	15 dhjetor 2029	333 430
	Totali:	10 000 000

UDHËZIM
Nr.31, datë 13.9.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME TRANSPORTIN
NDËRKOMBËTAR DETAR, AJROR DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT, TË MALLRAVE
DHE PASAGJERËVE ME TVSH ZERO**

Në mbështetje të nenit 31 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për TVSH-në”, të ndryshuar, Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit

UDHËZOJNË:

1. TVSH-ja aplikohet në masën zero për qind për furnizimin e shërbimeve në lidhje me transportin e mallrave dhe pasagjerëve dhe shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit, si më poshtë:

I. Transporti ndërkombëtar detar

a) Shërbimi për përdorimin e kanalit të portit, nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

b) Shërbimi për qëndrimin në kalatat e portit të mjeteve lundruese që operojnë në transport ndërkombëtar.

c) Shërbimi për qëndrimin në kalata pas veprimeve tregtare të mjeteve lundruese që operojnë për transport ndërkombëtar.

d) Shërbimi i përdorimit të kalatës nga mjetet lundruese që operojnë për transport ndërkombëtar.

e) Shërbimet shëndetësore dhe sanitare që kryhen në mjetet lundruese të destinuara për transportin ndërkombëtar.

f) Shërbimi për ngarkimin e mallrave, si dhe shërbimet ndihmëse (përpunimi i tyre, manipulimi në sheshe, magazinimi), për eksportin e kryer me mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

g) Shërbimi për shkarkimin e mallrave deri në kalata dhe për tranzit ndërkombëtar, si dhe shërbimet ndihmëse për këto të fundit (përpunimi i tyre, manipulimi në sheshe, magazinimi) të kryera nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

h) Shërbimet për ngarkimin e kontenierëve, si dhe shërbimet ndihmëse (magazinimi, përpunimi i kontenierëve, pastrimi, shërbimet mbështetëse), për eksportin e kryer me mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

i) Shërbimet për shkarkimin e kontenierëve deri në kalata dhe për tranzit ndërkombëtar, si dhe shërbimet ndihmëse për këto të fundit (magazinimi, përpunimi i kontenierëve, pastrimi, shërbimet mbështetëse) të kryera nga mjetet lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

j) Shërbimet për çdo prekje të trageve që operojnë në transportin ndërkombëtar;

k) Shërbimi për imbarkimin e pasagjerëve dhe mallrave të tyre për tragetet që operojnë në transportin ndërkombëtar.

l) Shërbimi për çimbarkimin e pasagjerëve dhe mallrave të tyre për tragetet që operojnë në transportin ndërkombëtar.

m) Shërbimet e pastrimit, riparimit apo mirëmbajtjes të mjeteve lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

n) Shërbimi për mbrojtjen kundër zjarrit për mjete lundruese dhe ngarkesën e tyre, që operojnë në transportin ndërkombëtar.

o) Shërbimi i furnizimit me pjesë këmbimi, materiale, karburant, vajra dhe me ushqime të mjeteve lundruese që operojnë në transportin ndërkombëtar.

II. Transporti ndërkombëtar ajror:

- a) Shërbimet për uljen e ngritjen e avionëve për transport ndërkombëtar.
- b) Shërbimi i ndriçimit të pistës së ulje-ngritjes së avionëve për transport ndërkombëtar.
- c) Shërbimi për drejtimin dhe parkimin e avionëve në pistë për transport ndërkombëtar.
- d) Shërbimet e pastrimit, ngarkimit dhe shkarkimit të avionit për transport ndërkombëtar të pasagjerëve.
- e) Shërbimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e avionëve për transport ndërkombëtar.
- f) Shërbimet për përdorimin e pajisjeve të aeroportit të destinuara për avionë për transport ndërkombëtar.
- g) Shërbimet që kryhen për sigurinë, ruajtjen dhe kontrollin e pasagjerëve dhe mallrave në aeroporte, të destinuara për transport ndërkombëtar.
- h) Shërbimet e avaro-shpëtimit.
- i) Shërbimi i furnizimit me materiale në avion, karburante për avionët dhe shërbimi katering në avion.

III. Shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit

- a) Shërbimi i interkonjeksionit ndërkombëtar.
- b) Shërbimi ndërkombëtar “Roaming”, i kryer nga një operator vendas për operatorë të huaj.

2. Në çdo rast, sipas specifikimeve të mësipërme, tatimpaguesi duhet të vërtetojë me anë të dokumentacionit përkatës se shërbimi i kryer është në funksion të transportit ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve.

Ky udhëzim publikohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËVE
PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I INOVACIONIT
DHE TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT DHE
KOMUNIKIMIT
Genc Pollo

URDHËR

Nr.4846/18, datë 20.9.2010

**PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE RREGULLAT E PAJISJES E ADMINISTRIMIT TË
VULAVE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 15 dhe 39 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimit nr.390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”,

URDHËROJ:

1. Pas certifikimit nga Ministri i Drejtësisë dhe marrjes së aktit administrativ përkatës nga Qendra Kombëtare e Licencimit për ushtrimin e veprimtarisë, përmbarruesi gjyqësor privat paraqet kërkesë pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, për pajisjen me vulën e njomë.

2. Vula e njomë ka formë rrethore me diametër 35 mm. Brenda saj shkruhen në formë harkore me shkronja kapitale fjalët “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” dhe poshtë tyre me shkronja

kapitale më të vogla shkruhet në një rresht të dytë emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i përmbaruesit gjyqësor privat ose emri i shoqërisë përmbaruese private. Në mes konturohet shqiponja dykrenare dhe poshtë saj në formë harkore në të kundërt të emrit dhe mbiemrit të përmbaruesit janë shkruar me shkronja kapitale, por të të njëjtës madhësi me ato të emrit, fjalët “PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT”.

3. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë i paraqet kërkesën për përgatitjen e vulave subjekteve shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur subjekteve private shqiptare ose të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente. Emrat e tyre miratohen paraprakisht nga Ministri i Drejtësisë. Përmbaruesi gjyqësor privat paguan paraprakisht tarifën të subjekti që përgatit vulën.

4. Vulat i dorëzohen strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë nga subjekti përgatitës i tyre. Vulat merren në dorëzim me procesverbal, të nënshkruara nga përfaqësuesi/t e përmendur sa më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Ministrisë së Drejtësisë. Struktura e Ministrisë së Drejtësisë njofton përmbaruesin që të paraqitet për marrjen në dorëzim të vulës. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga personi i autorizuar nga Ministri i Drejtësisë dhe nga përmbaruesi gjyqësor privat. Në procesverbal shënohet koha, vendi, emrat e pjesëmarrësve, si dhe fakti i marrjes së vulës në dorëzim nga përmbaruesi privat. Procesverbali hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga personat e lartpërmendur, ku secili mban një kopje të tij.

5. Pajisja e përmbaruesve gjyqësorë privatë me vula bëhet nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës së tij për t’u pajisur me vulë.

6. Institucioneve qendrore më të rëndësishme, si dhe subjekteve të tjera që vlerësohen nga Ministri i Drejtësisë se kanë lidhje të ngushtë me veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë privatë u dërgohet zyrtarisht, për çdo përmbarues gjyqësor privat, një fletë e bardhë e nënshkruar dhe e vulosur me vulën e tij.

7. Në çdo rast, modeli i vulave, emri dhe firma e çdo përmbaruesi gjyqësor privat i dërgohet për depozitim e model Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Bankës së Shqipërisë, si dhe bankave të nivelit të dytë, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, prokurorive dhe gjykatave.

8. Vula është personale dhe përdoret vetëm nga përmbaruesi gjyqësor privat. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t’u jepet në asnjë rrethanë të tretëve. Në rast se gjatë kontrolleve, konstatohet se vula e përmbaruesve gjyqësorë privatë përdoret nga persona të tretë, atëherë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, të ngarkuar me kontrollin, pasqyrojnë faktin në procesverbalin përkatës dhe i raportojnë Ministrit të Drejtësisë.

9. Vulat e përmbaruesve gjyqësorë privatë, që nuk e ushtrojnë më detyrën, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, kërkojnë e merren nga Ministria e Drejtësisë.

10. Përmbaruesi, i cili kërkon të pezullojë veprimtarinë e tij dhe që është pajisur me vulë, duhet të dorëzojë për asgjësim në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë vulën e tij. Procesverbali dokumenton dorëzimin dhe asgjësimin, si dhe hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e strukturës përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe nga përmbaruesi gjyqësor privat, ku secili mban një kopje të tij.

11. Përmbaruesi, i cili kërkon të rifillojë veprimtarinë përmbarimore, duhet të paraqesë kërkesë, për pajisjen me vulë të re, pranë strukturës përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë rast, zbatohen rregullat e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij urdhri për marrjen në dorëzim të vulës.

12. Në rastet e tjera, për asgjësimin e vulës, zbatohen rregullat e parashikuara në pikën 10 të këtij urdhri.

13. Pas asgjësimit të vulave si më sipër, Ministria e Drejtësisë vë në dijeni institucionet, të cilave u është dërguar më parë modeli i vulës dhe firmës së përmbaruesit, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe se dokumentacioni i paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat duhet konsideruar i pavërtetë.

14. Kur përmbaruesi, i cili është çregjistruar nga regjistri në Ministrinë e Drejtësisë, nuk dorëzon vulën, Ministria e Drejtësisë vë në dijeni institucionet, të cilave u është dërguar modeli i vulës së përmbaruesit dhe firma e tij, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe dokumentacioni i paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat, duhet konsideruar i pavërtetë.

15. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 4.10.2010
Doli nga shtypi më 6.10.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë